




Çmime të ulëta blerëse, izolim, të hyra të ulëta – PROBLEMET KRYESORE



A do t'i
shpëtojë
Evropa bletët



Shartimi i
kastravecit



Angjinarja –
perime e
perëndive



Luleshtrydhe
në fuçi



**GRURI SPELTA
(TRITICUM SPELTA)
DRITHI I SË ARDHMES**

10

**BIMË E PAVARUR
QË NUK KËRKON
SHUMË SHIRA**




12



**HURMA
DIOSPYRUS KAKI**

13

**USHQIMI I
VIÇAVE**



19



**Aktivitetet IKC:
NGRICAT E VONSHME
GJATË MUAJIT PRILL
NË KOSOVË**

30



FEDERATA E FERMERËVE NË R.M.

Adresa: rr. Hristo Smirnenski nr.15 1000 Shkup
Tel:389 02 3099 044, Faks:389 02 3099 044
e-mail: ffrm@ffrm.org.mk
uebfaqe:www.ffrm.org.mk



AGROPUKA

Adresa: Lagjja e Re, Pukë
Tel.+355 212 2 2412. Mob.:+355 68 23 88 169/
+35569 57 42 060/ +35567 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
uebfaqe: www.agro-puka.org



AGRINET ALBANIA

Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
uebfaqe: www.agrinet.al



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY

Adresa: rr. Gjon Serreçi, p.n, Ferizaj, Kosovë
Tel: 038742190, Mob:+377 (0)44 368 356
Faks: 038742190
e-mail:main@ngoikc.org
uebfaqe:www.ngoikc.org



WeEffect – Qendra Suedeze për Kooperativa, punon me organizatat partnere në mbi 20 vende, me vizion të botës së qëndrueshme dhe të drejtë të çliruar nga varfëria. WeEffect e mbështet revistën rajonale "Toka Ime" me qëllim që të zhvillohet lëvizja e bujqve në Ballkan dhe të përforcet zëri i përbashkët i bujqve.

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FFRM, AGRINET, AGROPUKA, IKC për Shqipëri-në, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit në suazat e sektorit bujqësor.



FEDERATA E FERMERËVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Toka ime, prill 2017

Botues: FFRM

Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Gigo Mihajlovski, nr. 4-1/1,
1000 Shkup

Udhëheqës: Bllagojçe Najdovski

Tel/faks: 02 3099042

e-mail: mojazemja@gmail.com

Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:
Biljana
Petrovska-Mitrevska
Botuar më:
prill 2017

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska

Gazetar: Nita Hadzihamza Gashi

Bashkëpunëtorë profesionale

Dr. Vitor Malutaj, Tomi Pikuli, Nikolin Karapanci, Sabah Djaloshi, Besmira Aliaj, Doruntina Kurteshi, Ekrem Bajrami, Ilir Gashi, , Dipl. agr. Dimitar Arnaudov, Dipl. agr. Vanko Zahariev, Eljona Meleq, Doc. dr. Zvezdan Bogevska, Doc. dr. Margarita Davitkovska, Eftim Karakamcev, dipl. arg. Llambe Kucinovski, Despina Kërstevska, Dimitar Arnaudov, Ardianë Lecaj, Dipl. arg. inxhi. Kostadinka Vasilevska

Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]

FUSHA E VERDHË - SIMBOL I DIELLIT



Me respekt,
Biljana Petrovska-Mitrevska
Redaktore e revistës „Toka Ime”

Nëse dëshiron ta prekësh diellin shikoje fushën e verdhë si shkëlqen. Ja ky është Dielli ynë ballkanik. Ky është një mendim i njohur ballanik i cili flet për shumë gjëra. Ballkani është vend rural ku gjithmonë burim i zhvillimit ka qenë bujqësia. Pikërisht këto vende kanë qenë të goditura gjithmonë nga varfëria, por në mënyra të ndryshme. Sot trendi i tillë jo vetëm që mundëson shkatërrim të fshatrave, largim të të rinjve por si rrjedhim edhe

ulje e trendit të zhvillimit të bujqësisë. Pse ndodh kështu? Një prej shkaqeve kryesore janë politikat e qeverisë, nga ana tjetër ndarja e bujqve dhe vendosja e teknologjive të reja në bujqësi dhe nga ana e tretë diskriminimi i grave në pjesën e zhvillimit të tyre arsimor dhe në zhvillimin e shpirtit të sipërmarrësit. Pikërisht “Toka ime” ka për qëllim temat e tilla t’i përpunojë në artikujt, analizat e veta me qëllim që fusha e verdhë të jetë përsëri simbol i diellit.

Tradita e Ballkanit - dhenaria në zhdukje



A do t'i shpëtojë



Shkruan: Bllagojçe Najdovski

Ekonomizimi i prodhimit të ushqimit kërkon përdorim të pesticideve. Shpesh thuhet se njerëzimi ka dy rrugë para vete, njëra është rruga e helmimit dalëngadalë me doza të vogla të preparateve kimike të cilat mbahen në fruta dhe të vdesë me ngadalë, kurse rruga e dytë është të vdesë menjëherë nga uria. Nga ana tjetër përdorimi i preparateve kimike

për mbrojtjen e bimëve gjatë lulëzimit të bimës është shpatë me dy tehe sepse duhet të zmadhohë rendimenti, por në të njëjtën kohë i vret edhe bletët që bëjnë pllenimin dhe e zmadhojnë rendimenti. 75% e kulturave kryesore bujqësore që i përdor njeriu modern në ushqim varen nga pllenimi i bletëve, pa pllenim të bletëve ulët dhe rendimenti i mollëve për 30%, luleshtrydheve për 35%, vishnjave për 40%, mjedrave për 45%.



NEONIKOTINOIDË

Një prej rreziqeve më të mëdha për mbijetesën e bletëve janë preparatet kimike për mbrojtjen e bimëve së pari pesticidet – neonikotinoidët të cilët thuhet se janë shkaktarë për zvogëlimin rapid të kolonive të bletëve në botë. Kur materia aktive bie në kontakt me lulen – (nektarin dhe polenin) ku bleta mund ta konsumojë ai akumulohet në organizmin e bletës dhe fillon të veprojë mbi sistemin nervor të bletës dhe ua zvogëlon aftësitë për aromë dhe mbajtje mend dhe i dezorienton. Bletët e helmua me një preparat të tillë

Evropa bletët



BASHKIMI EVROPIAN

Bashkimi Evropian do të ndalojë në fushat e veta përdorimin e neonikotinoidëve më të përdorur, momentalisht në BE janë ndaluar tre neonikotinoidë, kurse nëse propozimi i Komisionit Evropian miratohet neonikotinoidët do të hiqen krejtësisht nga pemi­sh­tet, fushat e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Sipas gazetës britanike Guardian, Komisioni Evropian dëshiron t'i ndalojë këto preparate kimike për shkak të "rrezikut akut për bletët". Ndalimi do të miratohet në vitin 2017, por së pari shumica e shteteve anëtare duhet ta miratojnë atë.




Bashkimi Evropian ka vendosur ndalimin e përkohshëm për përdorim të tre neonikotinoidëve në vitin 2013, por tani kërkohet ndalim i përhershëm, kurse përjashtim do të jenë ato kultura të cilat kultivohen në serrë. Për këtë propozim do të votohet në maj të vitit 2017, kurse nëse propozimi miratohet i njëjti do të hyjë në fuqi pas disa muajsh pas miratimit në shumicën e shteteve anëtare evropiane të BE-së.

PLLENIMI DHE EKONOMIZIMI

Në Shtetet e Bashkuara Amerikane pemi­sh­tet paguhen bletarë që të mbartin bletë për pllenim. Në vitet e fundit çmimi për pllenim të bajameve ka arritur edhe deri në 250 dollarë për një koshere në raport me çmimin prej 30 deri në 60 dollarë të cilin kultivuesit e bajameve e kanë paguar në të kaluarën, kurse shkaku është rënia e numrit të bashkësive të bletëve. Bletarët të cilët i mbartin familjet e veta të bletëve për pllenim të bajameve realizojnë të hyra solide prej mjal­tit dhe polenit të mbledhur.

Hulumtimet shkencore të bërë na Britaninë e Madhe dëshmojnë se një familje bletare, nëpërmjet pllenimit dhe ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike të natyrës dhe i sjell bashkësisë më të gjerë fitim prej 1200 Eurosh, prej të cilave bletarët nëpërmjet fitimit të bletëve prodhimet fitojnë nga 1,5 deri në 3%, kurse çdo gjë tjetër është fitim për pemëtarët dhe bujqit e tjerë. Është e saktë se prodhimi bimor nuk parafytyrohet pa përdorimin e pesticideve, por është e saktë se mund të anashkalohet zbatimi i tyre gjatë lulëzimit të bimëve. Megjithatë, helmimet më të mëdha të bletëve ndodhin tek amatorët e kopshtarisë të cilët nuk kanë shprehur të lexojnë udhëzimin për përdorim të preparatit deri në fund, por janë të interesuar vetëm për pjesën e dozimit të preparatit dhe shpesh e zmadhojnë atë sipas mendimeve të veta. ●

përrjetojnë paralizë, kurse më pas vdekje. Neonikotinoidët bëjnë dëm të madh të bletët dhe të gjithë pllenuesit, kurse për shkak të faktit se nuk ka zëvendësim për bletët si pllenues në natyrë zhdukja e tyre është kërcënim i drejtpërdrejtë për qytetërimin kështu siç e njohim. Aktivistët për mbrojtjen e mjedisit njerëzor nga ana tjetër prej më tepër se njëzet vjetësh debatojnë mbi dëmin që shkaktojnë këto preparate kimike. Prodhuesit e preparateve kimike këmbëngulin se këto kemikale janë me rëndësi të madhe për mbrojtjen e rendimentit të kulturave bujqësore dhe se rezistenca për përdorim të tyre është para së gjithash çështje politike.



Shartimi i kastravecit

Shkruan: Dimitar Arnaudov

Kastraveci është lloj perimesh që kultivohet në çdo kopsht dhe serrë. Kjo perime e ka prejardhjen nga Azia. Për shkak të përmbajtjes së lartë të ujit konsiderohet si diuretik i përkryer.

Përmban pak kalori, kurse përmban shumë vitamina dhe minerale. Për shkak të efektit pozitiv mbi trupin e njeriut përdoret si shtesë në ushqim, medikamente dhe qëllime kozmetike.

Gjatë kultivimit të kastravecit shumë kultivues ballafaqohen me faktorët kufizues të cilët ndikojnë në prodhim. Kastraveci ka rrënjë e cila është shumë e ndjeshme dhe e zhvilluar dobët. Sistemi rrënjor ballafaqohet shpesh me sëmundje të ndryshme dhe temperatura të ulëta të truallit. Që të anashkalojnë problemet e sistemit rrënjor të kastravecit, prodhuesit e shatojnë kastravecin me kungull si bazë. Për bazë më shpesh përdoret Cucurbita ficifolia.




Absorbim më i mirë i ujit dhe materieve ushqyese

Në këtë mënyrë anashkalohet ndikimi negativ i rrënjëve të zhvilluara dobët dhe krijohet ndikim mjaft pozitiv nga rrënja e kungullit. Kungulli ka sistem rrënjor, që është i zhvilluar më mirë dhe më i fuqishëm, i reziston më mirë temperaturat e ulëta si dhe vlera të larta të materieve minerale ushqyese në truall, mund të futet më thellë në truall, kurse kështu zmadhohet edhe rezistenca ndaj thatësirës.

Që të kryhet shartim i suksesshëm nevojitet të sigurohen bimët e reja të zhvilluara si duhet të kastravecit dhe kungullit, thikë e hollë për prerje, material për prerje, mjete për dezinfektim.


Mjeti kryesor për shartim është brisku ose bisturi. Teju duhet të jetë i gollë dhe i mprehtë, me qëllim që të anashkalohet thyerja e indit të butë të bimëve të reja. Para përdorimit të mjeteve ato duhet të dezinfektohen. Për dezinfektim përdoret permanganat kaliumi, alkool. •



SHARTIMI MUND TË KRYHET NË TRI MËNYRA:

1. Shartim me prerje,
2. Shartim me bashkim dhe
3. Shartim me kënd prej 30 deri në 45°.

Për shartim nevojitet të ketë bimë të reja të zhvilluara të kastravecit dhe kungullit. Kastravecët mbillen katër deri në shtatë ditë para kungullit.



1


SHARTIM ME PRERJE

Me këtë lloj shartimi të kungullit hiqet gjithë e parë e vërtetë dhe meristemi i sipërm, kurse lihen gjethet kotiledone. Pastaj bëhet prerje me thellësi deri në 2 cm ku futet bima e kastravecit. Sistemi rrënjor i kastravecit hiqet para se të vendoset në prerje.

2

SHARTIM ME BASHKIM

Te ky lloj shartimi në të njëjtën lartësi të kërcellit të kastravecit dhe kungullit bëhet një prerje e pjerrët pret 1/3 ose 1/2 e kërcellit. Në këtë mënyrë fitohen një lloj gjuhësh të cilat përputhen midis tyre.




3

SHARTIM ME KËND

Për këtë proces nevojitet që kastravecët dhe kungujt të kenë trashësi të njëjtë të kërcellit. Kërcejtë priten në kënd prej 30 deri në 45°. Në kungullin të cilit me prerje i hiqet meristemi shartohet pjesa e kërcellit të kastravecit.

Pas shartimit është e nevojshme që bimët të vendosen në hapësira të veçanta me kushte speciale dhe në kushte të tilla mbeten rreth 10 ditë.



ANGJINARJA

perime e perëndive

Shkruan: Doc. dr. Zvezdan Bogevska, Doc. dr. Margarita Davitkovska

Angjinaria (artičoka) është bimë shumëvjeçare. Konsiderohet si perime delikate dhe midis bimëve hortikulturore më të rëndësishme. Ekstraktet e gjetheve të saj kanë zbatim në industrinë ushqimore dhe farmaceutike.

Angjinaria (*Cynarascolymus*) e ka prejardhjen nga Mediterani ku është shpërhapur në Evropë. Kurse mandej në Amerikën e Jugut dhe të Veriut.

Angjinaria konsiderohet si perime e perëndive, sepse sipas mitologjisë perëndia Zeus e ka përdorur për ushqim. Ka qenë edhe ushqimi i preferuar i aristokratëve. Angjinaria është bimë shumëvjeçare e cila nëse është e mbrojtur mund të durojë kushtet më të ftohta të dimrit. Angjinaria kultivohet për lulet që mblihet para se të lulëzojë. Më e përhapur është në rajonin mesdhetar. Më shpesh kultivohet në kopshte edhe pse në disa pjesë të Mediteranit kultivohet në të mbjella më të mbjella përgjatë bregdetit. Angjinaria karakterizohet me vetitë ushqyese dhe mjekuese. Vepron si terapi për diabetin, aneminë dhe sëmundjet e mëlçisë. Nga një bimë në vit mund të merren 5-6

kurora lulesh më të mëdha. Kërçelli është i degëzuar dhe arrin lartësi dhe deri në 2m. Gjethet janë të mëdha dhe të vendosura në trung në mënyrë të ndryshme. Në majë janë me ngjyrë të gjelbër të errët, kurse në bazë gri. Në majën e gjetheve ka gjemba. Rrënja është shumë e thellë dhe e shpërndarë në truall. Në majën e kërcejve ku formohen lulet gjenden kurora lulesh të mëdha, të rrumbullakëta dhe me gjemba të përbëra nga lule të vogla me ngjyrë të kaltër në manushaqe. Nga bima fitohen 5-6 kurora lulesh të cilat formohen nga viti i dytë dhe mandej. Angjinaret i përshtaten truaj të thellë, pjellore, të shkrifëta dhe të lagështa. Temperatura optimale për kultivim është nga 24 deri në 26°C. Angjinaria nuk e duron hijen, por mund të kultivohet edhe në vende me era të fuqishme.

TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT TË ANGJINARES

Në Evropën e mesme, angjinaria prodhohet në fidanishte në kontejner, zakonisht prodhimi prej meristemit ose kulturës invitro që mundëson fitimin e fidanishtes pa virus. Në jug të Evropës kultivohet drejtpërdrejt nga



fara. Në sipërfaqe më të vogla shumëhet me sukses me prerje (mbjellje njëvjeçare ose dyvjeçare).

Prodhimi i fidanishtes fillon me mbjelljen në shkurt dhe mars në hapësirë të mbyllur pas tri javësh (në saks me diametër prej 9-12 cm). Më ekonomike është mbjellja me dy fara në saks (por atëherë prodhimtaria është më e gjatë për 21 ditë). Pas mbjelljes temperatura mbahet 18-22°C, kurse pas mbirjes 12-16°C. Mbjellja e fidanit bëhet pas përfundimit të rrezikut prej ngricave pranverore (maj) në largësi 80-100x75-80 cm dhe thellësi 5-10 cm. Për prodhimtarinë e her-

shme mbjellja mund të jetë më herët (në prill) duke përdorur material për mbulim (lutrasil, agrill et.). Në këtë mënyrë të prodhimit, angjinaria lulëzon që në vitin e parë.

Mbjellja e drejtpërdrejtë është nga gjysma e prillit deri në fund të majit (në varësi nga kushtet klimatike) në largësi prej 70-100x70-80. Është e shpeshtë dhe mbjellja në fole (3-4 fara), gjatë së cilës lihet vetëm bima e zhvilluar më shumë. Gjatë mbjelljes së drejtpërdrejtë lulëzimi ndodh në vitin e dytë.

Shumimi vegetativ është me degë, përkatësisht me preje të gjelbra. Me zhvillimin e bimës në pranverë (prill-maj) priten lastarë të gjelbër (me 3-5 fletë dhe një pjesë e rrënjës). Lastarët mbillen në largësi prej 100-120x80-90 cm (kurorat e mëdha në largësi më të mëdha).

Angjinaria pas mbjelljes në kushte optimale zhvillohet shpejt dhe mbrojtja nga barërat e këqija kryhet vetëm mekanikisht në fillim të vegetimit. Rezultate shumë të mira jep mbulimi me materie organike menjëherë pas mbjelljes. Angjinaries dëmet më të mëdha ia shkaktojnë viruset, prandaj përdoret material fare pa virus. Nga sëmundjet tek angjinaria shfaqen bakteriet dhe fuzarium.



Gjatë kultivimit prej fidanishtes dhe lastarëve, angjinaria lulëzon në të njëjtin vit (shtator). Lulet zhvillohen shpesh herë gjatë vitit, dhe kjo, nga korriku deri në gusht, kurse në jug nga maji deri në nëntor. Lulet do të zhvillohen shkallë-shkallë dhe pastaj vjelja do të vazhdojë deri në ngricat e para. Lulet janë të gjata 8-16 cm dhe me peshë 200-500 g. Për fitim të luleve më të mëdha në bimë lihen 2-3 degë me 2-3 lule.

Mbledhja e luleve bëhet në periudhën kur gjethet e jashtme nga lulet do të fillojnë të ndahen nga të mesmet, kurse brendësia janë ende të mbyllura. Lulet priten me kërcell të gjatë 10-15 cm dhe ruhen në vend të ftohtë (përndryshe nxihen shpejt). Në bimë zhvillohen 2-3 kurora lulesh të mëdha dhe 4-10 të mesme. Rendimenti vjetor është nga 40.000 deri në 100.00 kurora lulesh përkatësisht 4-10 t/ha. Më cilësore është angjinaria e vitit të dytë dhe të tretë. Kurorat e luleve të ruhen një muaj në temperaturë prej 00C dhe lagështi relative prej 95%.

MBROJTJA NGA TEMPERATURAT E ULËTA

Gjatë dimrit angjinaria kërkon mbrojtje nga temperaturat e ulëta. Kurorat e lulëzuara duhet të hiqen, kurse gjethet e gjatë të priten pak dhe së bashku të lidhen në duaj. Gjatë ditëve të ftohta, bimët mund të mbulohen me kashtë, degë etj. Në rajonet me dimra shumë të ftohtë, angjinaret duhet të shkulen dhe së bashku me një copë tokë dhe të mbillen në saksi me rrëzë dhe të ruhen në podrum. Për ushqim përdoren kurorat e reja me lule të cilat mblidhen në maj dhe qershor, kur piquen edhe kurorat e luleve. Për konsumim nuk përdoren në gjendje të freskët, sepse kanë shike të hidhur dhe organizmi i njeriut i përpu non me vështirësi. Kurorat e luleve të papjekura duhet të përgatiten menjëherë pas mbledhjes, sepse nga ruajtja më e gjatë ndryshon shija dhe vlera ushqyese. Për konsumim përdoren gjethet të cilat gjenden në bazën e kurorës së lules dhe pjesa e brendshme kurorës së lules.

VETITË MJEKUESE TË ANGINARES

Angjinaria është bimë mjekësore e për shkak të pranisë së cinarinës në gjethe. Cinarina ka shije të hidhur, e përmirëson funksionin e mëlçisë dhe të qeskës së urinës, e nxit sekrecionin e lëngjeve të tepërta dhe e zvogëlon nivelin e kolesterolit në gjak. Gjethet e angjinaries veprojnë edhe kundër reumës, ngërçeve dhe ndihmojnë gjatë uljes së sheqerit. Gjithashtu, përdoret për qetësimin e dhimbjeve në stomak, acide, sekrecioni i hepatitisit dhe arterosklerozës. Angjinaria është e pasur me minerale dhe vitamina, kurse përmban edhe proteina, hidrate karboni dhe pak yndyra. Prej mineraleve përmban kalium, natrium, fosfor, magnez, kalcium, bakër, hekur dhe xing. Angjinaria është e pasur edhe me vitaminë A, C dhe vitamina të grupit B. Për shkak të përmbajtjes së lartë të fibrave bimore, angjinaria përdoret për përmirësimin e tretjes së ushqimit. ●



GRURI SPELTA (Triticum Spelta) DRITHI I SË ARDHMES

Shkruan: Zahariev Vanço inxhinier bujqësor i diplomuar

Spelta si bimë drithore së bashku me limet një kokërr dhe dy kokrra janë forma të lashta të drithërave të cilat i kanë përdorur civilizimet e lashta si drithë për bukë. Në kohën e sotme njerëzimi është i rrezikuar nga prezenca e ndotjes së mjedisit të shkaktuar nga shkaktarë të shumtë të cilët si të tillë janë të pranishëm edhe rrezikuar e grurit si produkt bimor.

Duke e pasur parasysh këtë si dhe faktin se përbërja e kokrrës të llojet e sotshme të grurit për shumicën e njerëzve është me shije të mirë, shumica e të interesuarve fillojnë të jenë më të motivuar, dhe filluan t'u kushtohet më shumë vëmendje këtyre formave kulturore të lashta të harruara të drithit para së gjithash nga aspekti i përbërjes së kokrrës së tyre e cila nuk shkakton probleme të atilla shëndetësore si llojet aktuale të drithërave dhe nga aspekti i aftësisë së tyre më të madhe për të mbijetuar dhe mundësisë të mbijetojnë në kushte jo të volitshme agroekologjike, kështu mundësohet kultivimi i tyre natyror. Këto forma të lashta të drithërave janë me trung të lartë dhe me kokërr të mbuluar me kashtë – luspë e cila para bluarjes duhet të hiqet nga kokrra. Edhe pse të gjitha këto forma janë kultivuar nga prodhues organik megjithatë spelta është më e përhapur meqenëse njihet për rendimentin e madh dhe për më shumë kokrra dhe së këndejmi, ka interes më të madh për të. Për të njëjtën konsiderohet se është krijuar para



5-6000 vjet para erës sonë në Anadoli të Turqisë, nëpërmjet kryqëzimeve spontane të bimëve drithore barishtore. Gjenetiki është ngjashme me format e sotshme kulturore të drithërave dhe si formë kulturore posedon qëndrueshmëri, jep miell me veti të shkëlqyera për të bërë bukë fure dhe bukë me shije shumë të këndshme. Prodhuesit e speltës në mënyrë gjithnjë e më masive i zhvendosin prodhimet e llojeve aktuale të drithërave sepse janë më të përhapura sëmundjet nga disa forma të mostolerancës ndaj përbërjes së llojeve aktuale të drithërave. Për shkak se gjenetiki është

është më e ngjashme me format drithore pa kokrra, ndërsa mangësi e ka pasur në të kaluarën trungun e lartë dhe të brishtë atëherë dhe tani bëhen kryqëzime me format e drithërave me trung të ulët dhe me kokrra të mëdha të drithërave të zakonshme dhe të buta me qëllim të fitojnë lloje me trung të ulët dhe që nuk janë të kërcënuara gjatë hedhjes së plehut i cili nevojitet që të fitohet rendiment më i lartë. Nga informatat në dispozicion mund të thuhet se me seleksionim të përkushtuar të punës në Gjermani janë krijuar shumë lloje të speltës, ndërsa në Hungari është krijuar lloji OKO- 10 dhe në Serbi lloji Nirvana. Të gjitha janë me trungje të ulëta dhe me veti cilësore të përafërta ose tërësisht të njëjta me speltën. Këto lloje të reja të krijuara të speltës kanë përmbajtje të larta të proteinave të cilat te disa lloje kalon 20% gjatë kësaj të njëjtat paraqesin raport ideal me karbohidratet, yndyrat, materiet minerale, vitaminat dhe fijet bimore. Spelta është drithi i njëjtë dhe ushqim, i cili me ujë mund t'ia sigurojë njeriut të gjitha materiet e nevojshme ushqimore për jetë. Të gjitha 8 amino-acidet të cilat trupi i njeriut nuk mund t'i sintetizojë për shkak se nevojitet konsumi i tyre me ushqim dhe në masë të madhe janë të pranishme në speltë krahasuar me llojet e zakonshme të drithërave.

Kokrra e speltës është e ngjashme me kokrrën e llojeve moderne të drithit të butë vetëm se është më e shprehur brazda dhe është e mbështjellë me



kashtë - luspë, e cila përbën 22 - 30% të peshës. Gjithashtu ka përmbajtje të pasur të materieve minerale dhe vitaminave, në veçanti vitaminë B1, B2 dhe Niacinë dhe selen si mineral i cili është i rëndësishëm në preventivën kundër kancerit si sëmundje. Nga kokrrat e pastruara nga kashta bëhen dy lloje të miellit: Me përbërje të plotë dhe miell i bardhë. Nga mielli me përbërje të plotë (kokrra plotësisht të bluara) përgatitet bukë e cila është me ngjyrë kafe, me shije të këndshme të ëmbël dhe ka butësi të cilën e ruan gjatë gjithë javës. Buka nga mielli i bardhë është e ngjashme me bukën e bardhë të rëndomtë me dallim që qëndron e butë për kohë më të gjatë dhe është elastike. Gjithashtu buka nga spleta në dietën e personave me diabet rekomandohet më tepër sesa buka e zakonshme. Është vërtetuar, vetia kuruese e lëngut të fituar nga gjethet e bimëve një javore të reja nga soleta në parandalimin dhe kurimin e kancerit të njeriut. Nëse ka interes për kultivimin e llojit Nirvana, si përfaqësues i drithërave speltë dhe krijimi i Institutit për Prodhime Bujqësore në Novi Sad duhet të dihet se e njëjta është me vegjetacion më të vonshëm, me lartësi

mesatare të trungut prej 107 - 117 cm, i reziston të ftohtit dhe përshtatet në kushte të ndryshme agroekologjike të kultivimit. Rekomandimet nga hulumtimet thonë se koha optimale për korrje në vite me thatësi është gjysma e parë e tetorit, ndërsa në vite me lagështi gjatë gjysmës së dytë. Norma e korrjes është 500 kokrra për metër katror, respektivisht 201 - 230 kg/ha. ASgroteknika gjatë kultivimit të saj është e zakonshme si te kulturat e tjera drithërore me atë që në tokë pjellore aspak nuk ka nevojë për fertilizues, ndërsa në tokë mesatarisht pjellore dhe të varfër shtohet fertilizues deri në gjysmën e normës krahasuar me atë që aplikohet në sortat aktuale të drithërave. Për shkak të madhësisë së aftësisë jetësore për vegjetacioni mund të zhvillohet pa paraqitjen e sëmundjeve dhe dëmtimeve. Rendimenti shkon deri në 4000 kg për hektar. Sipas rezultateve zyrtare nga hulumtimet për këtë lloj, pjesa që i takon kashtës dhe luspës përbën rreth 22%, pesha hektolitare rreth 77 kg, pesha absolute 41 gram, përmbajtja e proteinave të përgjithshme prej 15 - 17%, materiet minerale 1,7 dhe rreth 15 % gluten të thatë. Lloji futet në grupin cilësor A2. ●

BIMË E PAVARUR

QË NUK KËRKON SHUMË SHIRA

Shkruan: Dipl. arg. inxhi. Kostadinka Vasilevska

Në Maqedoni qershia është më e përhapur në Rajonin e Ohrit, por kohët e fundit po zhvillohet edhe në rajone të tjera. Klima më e mirë për të është ajo mesatare, kurse e pengojnë ngricat dimërore dhe temperaturat e larta. Përndryshe, ajo është frutë që duron mirë temperaturat e ulëta deri në - 20°C, mirëpo jo për një periudhë të gjatë, përkatësisht vetëm nëse temperaturat e tilla mbahen për një kohë të shkurtër. Në aspektin e ngritjes së fidanëve të rinj me qershë duhet t'i kushtohet vëmendje edhe intensitetit të reshjeve gjatë vegjetimit. Shirat shumë intensive gjatë pjekjes shkaktojnë plasjen e


frutës. Nuk i përshtaten tokat të cilat e mbajnë ujin në sipërfaqe sepse kjo mund të shkaktojë kalbëzim të rrënjës. Me fjalë të tjera, qershia kërkon tokë të drenuar dhe të pasur me materie organike. Për të ngritur një fidanishte të re është e nevojshme të bëhen analizat e tokës me qëllim që të përcaktohet cilësia e tokës, dhe në bazë të asaj analize vendoset se cila shtresë do të përdoret në atë tokë. Në aspektin e plehërimit, për qershinë është më mirë të përdoren plehra organike. Më të përshtatshëm janë me pH neutral dhe me aciditet të dobët. Trojet me aciditet dhe karbon të theksuar nuk janë të për-

shtatshme sepse e shkatërrojnë ushqimin dhe shkaktojnë klorit (djegie) të gjethes. Qershia është bimë vetësterilizuese që do të që në një pemëtore është më mirë ketë të pranishme lloje të ndryshme përveç asaj kryesore që të mundësohet plotësim më i mirë. Në aspektin e mënyrës së kultivimit, qershia shumë shpejt ka kaluar nga mënyra ekstensive në atë intensive të kultivimit. Largësia e mbjelljes varet nga lloji i truallit dhe kjo lëviz nga 5x5 deri në 4x3. Nga shtresat, më të përhapura janë qershia e egër, magriva, kurse kohët e fundit rëndësi të veçantë i jepet shtresave invitro. ●



ZIRAAT 0900

Prejardhja e Ziraat 0900 është nga Anadolli, Turqi. E njohur edhe me emrin Napoloni Turk. Druri karakterizohet nga dendësia dhe rritja e lartë. Është një lloj vetësterilizues dhe prandaj është e nevojshme që në pemëtore të ketë edhe ndonjë lloj tjetër për plotësim. Në aspektin e kushteve klimatike kërkon klimë mesatare, jo shumë të ngrohtë, sidomos në periudhat e verës. Mund të kultivohet në lartësi mbi nivelin e detit nga 500 deri në 1800m. Si shtresa për kultivim të Ziraat 0900 janë: Maxma14, Maxma60, Gizela6, CAB, PHLA. Në bazë të kësaj lëviz edhe rendi i mbjelljes nga 4x3 deri në 5x5 ose 40-80 fidanë për dynym. Fruta është me madhësi mesatare, me tul, me ngjyrë të kuqe të errët dhe ka peshë 9-9,5 gram. Është e përshtatshme për transport të gjatë dhe ruhet gjatë në kushte të kontrolluara. Fruta nuk plasaritet dhe vjelja është në javën e tretë të qershorit. Prodhimtari të plotë ka pas vitit të pestë, kështu që vjetërsia e saj është 25-30 vjet. Rendimenti i pritur është 800-1000 kg për hektar.



Hurma diospyrus kaki

Shkruan: Eftim Karakamçev

Hurma quhet edhe ushqimi i perëndive. Prejardhjen e ka nga Kina dhe Japonia prej nga shpërhapen në të gjithë botën. Në Evropë është përhapur shumë në shekullin e 19 dhe piqet në rajonet me klimë të butë mesdhetare.

SHUMIMI DHE NGRITJA E PEMISHTVE

Shumohet me lehtësi me shartim me prerje T në koren. Shartimi mund të bëhet në pranverën kur sythi është çelur dhe në vjeshtë kur sythi është i mbyllur. Si bazë për shartim përdoret sythi i llojit Diospyros lotus ose Diospyros virginiana. rekomandohet shartimi të bëhet në lartësi prej 20-30 cm. Largësia e mbjelljes është 5x5 ose 5x4 m. Reagon shumë mirë ndaj plehërimit me pleh të djegur bagëtie.



LLOJET

Llojet ndahen në dy grupe:

Adstingentë – (lloje të cilat e mpiksin gjuhën gjatë konsumimit): Hakume, Eureka, Gales, Tamopan, Cokolate, Kostata, Rojo Brillante

Joadstingentë (lloje të cilat konsumohen menjëherë): Fuyu, Jiro, Imoto, Izu....

Në rajonin e Valandovës më të përhapura janë llojet Kostata, Fuyu dhe në disa vitet e fundit ka filluar të mbillet shumë dhe lloji Jiro Brillante.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES PËR MBJELLJE

Para plugimit kryhet hedhja e sasive të nevojshme me plehra organike dhe minerale në bazë të rezultateve të marra nga analiza agrokimike e tokës dhe nevojat për elemente ushqimore të frutës. Plugimi bëhet në thellësi prej 60-70 cm në muajt e verës, kurse në vjeshtë kryhet lërimi në thellësi prej 30-40 cm. Para mbjelljes kryhet rrafshim me qëllim që të shkriftohen plisat. Para mbjelljes kryhet përcaktimi i drejtimt të radhëve, matja e largësisë dhe shënimi i vendeve për mbjellje me kallama.

MATERIALI MBJELLËS

Materiali mbjellës duhet të jetë me cilësi të lartë, i prodhuar dhe i certifikuar nga prodhues të regjistruar të materialit për mbjellje ose mund të sig-

urohet import nëpërmjet importuesve të regjistruar. Fidanët duhet të jenë të zhvilluar, tërësisht të shëndetshëm dhe të lirë prej viruseve dhe mikoplazmave

TEKNIKA E MBJELLJES

Mbjellja mund të kryhet në gropa të hapura manualisht, me turjelë të vendosur në traktor ose në brazda.

Mbjellja në gropa është proces më i ngadalshëm dhe më i shtrenjtë. Mbjellje cilësore, e shpejtë dhe e lirë është me brazda. Brazdat bëhen me plug të njëtrajtshëm, 15-20 cm djathtas radhëve të shënuara. Brazda duhet të jetë e thellë 40-50 cm. Me masë prej 50 cm fidanët mbillen përafërsisht në mes të brazdës. Thellësia e mbjelljes së fidanëve është disa cm mbi vendin e bashkimi prej sipërfaqes së truallit, kurse vendi i bashkimit nuk duhet të mbulohet me dhe me qëllim që të zhvillohen degë nga pjesa e butë e frutës. Kur fidani do të vendoset në vendin për mbjellje vendoset pjesa e sipërme pjellore e tokës dhe skelet, kurse pjesa tjetër nuk shkelet. Në fund hidhen rreth dhjetë litra ujë me qëllim që të dalë ajri dhe të ngjitet më mirë me truall, kurse kështu sigurohet pranim i sigurt i fidanit. Gjatë mbjelljes së vjeshtës kryhet mbulim i vendit të bashkimit në fidan me qëllim që të anashkalohen pasojat prej ngrirjes gjatë temperaturave të ulëta.

Pas mbjelljes pemishtja rrethohet me gardh prej rrjete që të ndalohet dëmtimi nga brejtësit dhe gjedhi. ●

Çmime të ulëta blerëse,

Rënia e sistemeve socialiste, tranzicionet dhe konfliktet ndërfqinjore i ka goditur shtetet në Evropën Juglindore dhe si pasojë ka qenë prapambetja ekonomike dhe përforcimi i varfërisë. Kjo reflektohet me migrimet e mëdha fshat - qytet dhe largimi nga shtetet. Pikërisht disa prej shteteve më të goditura janë Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Goditje të veçantë prej të gjitha reformave, tranzicionit pësuan vendet rurale ku u shfaq dukuria e varfërisë rurale. Cilat janë pasojat, grupet më të goditura dhe sfidat mbi të cilat duhet të punohet është analizuar nga Toka ime.



Varfëria rurale në Shqipëri

Shqipëria është një vend i vogël me një popullsi prej 3.1 milion banorë. Ajo ka në përgjithësi një territor malor dhe vetëm 24% e tokës klasifikohet si tokë bujqësore, 36% si pyje dhe 15% janë kullota. Bujqësia është ende sektori më i madh kontribuues për gjenerimin e të ardhurave për pjesën më të madhe të popullsisë, si dhe një burim punësimi. Popullsia rurale përbën 54% të popullsisë së përgjithshme dhe 71% e fuqisë punëtore është e punësuar në aktivitete bujqësore ose në bujqësi.

Përkundër gjithë kësaj, në Shqipëri ende ekziston një varfëri e vazhdueshme, veçanërisht në zonat rurale. Sipas studimit të fundit të Matjes së Standardeve të Jetesës (LSMS), 18.5% e të gjithë shqiptarëve janë të varfër. Kjo shifër është edhe më e lartë në zonat rurale, ku 24.2% e popullsisë është e varfër.

Njerëzit që jetojnë në zonat rurale janë dukshëm më të varfër se ata që jetojnë në zonat urbane. Kjo varfëri ka shumë dimensione të tilla si:

1. Nivele të ulëta ose shumë të ulëta të të ardhurave;
2. Shkalla e lartë e rreziqeve shëndetësore dhe mungesa e shërbimeve të duhura mjekësore;
3. Analfabetizmi ose niveli i ulët i arsimimit;
4. Qasje të kufizuar në procesin e vendimmarrjes së qeverisë.

Nivelet e varfërisë janë relativisht më të larta në grupe e popullatës për të cilat bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave. Kjo mbështetet dhe nga fakti që rreth 50 përqind e të varfërve janë fermerë. Bujqësia tradicionalisht ka luajtur një rol të rëndësishëm në ekonomi, duke përbërë 24 përqind të GDP -së dhe 58 përqind të punësimit. Bujqësia dominohet nga fermat e vogla (më pak se 1.2 ha), të fragmentuara në 3 deri në 4 parcela. Ky fragmentizim është një pengesë e rëndësishme për një zhvillim efikas dhe të qëndrueshëm të bujqësisë Shqiptare. Sipas të dhënave zyrtare, blegtoria përbën 45% të vlerës totale bujqësore të shtuar, bimët e arrave 44% dhe frutikultura 11%. Gjatë pesë viteve të fundit, frutikultura kanë treguar ritmin më të lartë të rritjes (rreth 7% në vit), si dhe me vreshtarinë që po rriten veçanërisht me rritme të larta. Këto të dyja përbëjnë një potencial të lartë për rritje të mëtejshme. Ndërsa blegtoria është rritur në rreth 3%. Bujqësia në Shqipëri vuan nga konkurrenca e ulët dhe



prodhuesit vendas shpesh herë detyrohen të pranojnë të ardhura shumë të ulëta, në mënyrë që të konkurrojnë me produktet e importuara. Disa statistika të mëposhtme reflektojnë situatën e prodhimit dhe të nivelit të ulët të fermave si:

1. Rendimenti i drithërave është ndërmjet 3 dhe 3.5 t/ha, i cili është i ngjashëm me rendimentet e arritura në vendet e tjera të Evropës Lindore dhe rreth 65% të prodhimit mesatare në vendet anëtare të BE;
2. Vetëm 73% e familjeve të përfshira në aktivitete bujqësore kryejnë operacionet kryesore të tokës me makina, 24% e fermerëve përdorin kafshë për të mbjellë tokën, 63% e fermerëve përdorin makina për të përgatitur tokën, por shumë punë të tjera i realizojnë manualisht dhe pa mekanikë;
3. Rreth 70% e fermerëve blejnë inpute si fara, plehra kimike dhe pesticide. Shpenzimet më të larta për fermë janë për plehurat kimike, të cilat përbëjnë rreth 40% të shpenzimeve për inpute. Rreth 40-45% e fermerëve blejnë ushqime për blegtorinë.

Si rezultat i efikasitetit të kufizuar të bujqësisë shqiptare, prodhimi dhe të ardhurat e krijuara nga bujqësia janë të ulëta, krahasuar me standardet e BE - së. Sipas përlllogaritjeve kombëtare, vlera e shtuar e zhvillimit bujqësor dhe rural është rreth 1.2 milion €. Me rreth 756,000 njerëz të punësuar në bujqësi, vlera e shtuar për punëtor është rreth 1,700 €. Kjo është larg nga 26,000 € nga BE dhe 6,500 € nga vendet e reja të cilat do të pranohen.

Ndërkohë që bujqësia do të vazhdojë të luajë një rol dominues në zonat rurale, veçanërisht si burimi kryesor i punësimit, bizneset

izolim, të hyra të ulëta -PROBLEME KRYESORE



rurale jo bujqësore zhvillohen për të përmirësuar mundësitë e të ardhurave, për të reduktuar papunësinë dhe emigrimin. Remitancat janë një mjet për investime fillestare në zonat rurale; Por ato plotësohen nga shërbimet financiare nëse duhet të arrihet rritja e qëndrueshme. Mbështetja e qeverisë përfshin stimujt për fillimin dhe rritjen e ndërmarrjeve në zonat rurale, duke përfshirë skemat konkurruese të granteve, me pronësi të fortë vendore. Siguron financime për trajnime profesionale, veçanërisht në aftësitë e biznesit, dhe për teknologjinë e informacionit dhe sistemet e informacionit të tregut.

Shqipëria ka fituar përvojë të konsiderueshme në mobilizimin e komuniteteve lokale, kryesisht përmes kontributit të një numri programesh financimi të donatorëve ndërkombëtarë. Në përgjithësi, rezultatet praktike nga zbatimi i tyre i kanë bërë këto programe atraktive për njerëzit lokalë. Megjithatë, një vlerësim i kohëve të fundit i Projektit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Rural identifikoi se një numër i nevojave kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm, duke përfshirë:

1. Ofrimin e trajnimeve për anëtarët e mundshëm të Grupit të Veprimit Lokal (LAG);
2. Përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara;
3. Përpjekje afatgjata për të ndryshuar qëndrimet dhe praktikat lokale në menaxhimin e burimeve natyrore;
4. Përfshirje më e mirë e LAG-ut në rrjetet ndërkomunale kombëtare dhe ndërkombëtare. ●

Varfëria rurale në Kosovë

Që nga pas lufta e deri më sot, termi varfëri ka qenë term i cili e ka preokupuar shoqërinë kosovare. Ekonomia e Kosovës është duke u përballur me shumë sfida, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 29.7 % e popullsisë së Kosovës jetojnë nën kufirin e varfërisë, ndërsa 10.2% jetojnë në varfëri ekstreme. Varfëria theksohet sidomos në zonat rurale në mes të grave dhe të rinjve, ku dihet që 60% e popullsisë jeton në zonat rurale.

Për fat të keq, Kosova po perceptohet si mjedis pesimist, vend ku sidomos të rinjtë nuk shohin të ardhme, kjo reflekton me numrin e madh të migracionit gati 100.000 persona (në mes të vjeshtës 2014 dhe fillimit të vitit 2015). Qasja e pabarabartë e grave në arsim dhe edukim si dhe pjesëmarrja tejet e ulët e tyre në ngjarje kulturore, shoqërore dhe ekonomike ka lënë pasojë në pozitën e femrës në familje dhe shoqëri. Papunësia e lartë veçanërisht te gratë vjen si rezultat i nivelit të ulët të arsimit, të cilave nuk iu është dhënë mundësia të punësohen dhe të kontribuojnë sadopak në të hyrat familjare.

Duke parë që në produktet bujqësore ekziston një hendek i madh ndërmjet importeve dhe prodhimit vendor, ku pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në tregtinë e përgjithshme është 4% ndërsa importi 24%. Kultivimi i kulturave të pemëve të imëta ka një rëndësi të veçantë si në krijimin e vendeve të reja të punës po ashtu edhe në zhvillimin e ekonomisë së vendit, përmes zëvendësimit të importeve me produkte cilësore, dhënie të mundësive konsumatorëve kosovarë për të shijuar kulturat e ndryshme frutore me cilësi të lartë dhe me çmim më të përballueshëm për ta.



→ Gjatë punës së saj ku IKC vepron, ka parë për së afërmi gjendjen në komunitetet në viset rurale, e cila është shumë e pafavorshme e shoqëruar me papunësinë, jetën pasive shoqërore dhe mungesë të arsimit. Kryesisht të hyrat në këto familje kanë qenë tejet të ulëta, ku burim kryesor ka qenë asistencë sociale nga Ministria e Mirëqenies Sociale. Ato familje të cilat kanë zhvilluar veprimtari bujqësore, nuk kanë sipërfaqe të mëdha të tokës, dhe nuk kanë pasur aftësitë apo edukimin përkatës për të kultivuar kulturat që janë më fitimprurëse. Për më tepër këta fermerë të vegjël tregojnë gjithnjë interesim për të përfituar grante apo ndihma të tjera nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë, mirëpo kriteret e përcaktuara nga ky institucion janë të pa kapshme e cila ju pamundëson të jenë përfitues.

IKC, identifikoi disa nga këto raste të cilat treguan gatishmërinë e madhe për të fituar aftësitë dhe për të filluar biznesin e tyre, kështu organizoi fillimisht trajnime në fushat e Udhëheqjes, Marketingut, Plan Biznesi, Menaxhim të Organizatës, Gratë dhe të Drejtat Politike, Barazia Gjinore. Për më tepër sipas nevojave IKC gjithashtu organizoi edhe trajnime teknike mbi kultivimin e kulturave bujqësore si: përgatitja e tokës, kultivimi, të ushqyerit, menaxhimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve etj.

Përveç këtyre aktiviteteve të realizuara, IKC me projekte të përbashkëta me partnerët e saj si Komunitatet e Shtimes, Vitisë ndihmoi këta fermerë me shpërndarjen e fidanëve të mjedrës, dredhëzës, shalqirit, sistemin e ujitjes pikë-pikë, foli të zezë. Fermerët përveç trajnimeve, fidanëve dhe sistemit të ujitjes, janë përcjellë vazhdimisht dhe janë këshilluar nga agronomët e IKC-së që nga fillimi i punës e në vazhdimësi. Ata gjithashtu kishin mundësi të vizitonin kultivuesit e njohur vendas dhe në rajon përmes vizitave studimore. Vizitat u përqendruan në njohjen e potencialeve të veta për përmirësimin e prodhimit dhe zhvillimin e shkëmbimit të tregut të prodhimeve bujqësore. Qëllimi i përgjithshëm i vizitave studimore është krijimi i lidhjeve të tregut dhe përmirësimi i bujqësisë në zonat rurale të Kosovës.

IKC gjithashtu e nxitur nga nevojat e fermerëve të cilët u ballafaquan edhe me sfida të tjera, kreu intervenim edhe tek procesi i qasjes sa më të lehtë në tregje për ta, duke u lehtësuar shitjet e prodhimeve të tyre përmes marrëveshjeve me kompanitë lokale si "Doni Fruits" dhe "Moea". Gjithashtu ndërmjetësoi marrëveshjen e fermerëve me kompaninë lokale "Fitofarma", për të blerë inputet bujqësore me 10% zbritje si dhe me grejs periudhë.

IKC vazhdon të qëndrojë afër të gjithë fermerëve dhe të përcjellë zhvillimin e tyre. Kjo shprehet edhe me organizimin e aktiviteteve të tjera siç janë panairët, përmes së cilave bëhet promovimi i produkteve të tyre, vizitave studimore si në vend ashtu edhe të vendeve në regjion. ●



Varfëria rurale në Maqedoni

Migrimi apo depopullimi i zonave rurale është një prej problemeve më të mëdha të cilat kontribuojnë në shkatërrimin dhe zmadhimin e varfërisë në zonat rurale. Është evident zvogëlimi i numrit të njerëzve të cilët jetojnë në mjediset rurale nga viti 1960 kur 982.221 persona jetonin në zonat rurale, 786.496 njerëz në vitin 1994, kurse në vitin 2015 ka pasur trend të zmadhimit të këtij numri në 891.573 njerëz. Analiza e Bankës Botërore zbulon trend të plakjes së popullatës në zonat rurale, me grupin më të madh të njerëzve në zonat rurale të cilat i takojnë moshës mbi 65-vjeçare. Kjo grupmoshë zgjerohet në numër me 4696 persona në vitin 1960, kurse 12.323 persona me moshë mbi 65-vjeçare në vitin 2015. Nga ana tjetër, numri i fëmijëve në moshën 0-14 vjet ka trend zvogëlimi nga numri katastrofal 37.992 fëmijë në vitin 1960, në 25.278 në vitin 1995 dhe 16.953 në vitin 2015. Përveç kësaj, standardi jetësor i popullatës në mjediset rurale është pesë herë më i ulët se mesatarja standardit jetësor në shtet.

Sipas anketës së Qendrës për Hulumtim dhe Krijim të Politikave në vitin 2011 standardi jetësor mesatar për familjet rurale ka qenë 5424 denarë/muaj (88 euro), në krahasim me 25.771 denarë/muaj (420 euro) për popullatën e cila jeton në qytet. Sektori bujqësor, tradicionalisht, karakterizohet nga rrogat më të ulëta në shtet, e cila në vitin 2017 është 16.740 denarë (rreth 270 euro). Edhe pensionet më të ulëta gjithashtu, mbeten ato në bujqësi. Pensioni minimal i marrë bujqit është 3.744 denarë (60 euro) në dhjetor 2010, kurse pensioni mesatar bujqësor në të njëjtën periudhë është 6.282 denarë (diçka më pak se 100 euro). Pensioni (i tërësishëm) bujqësor është marrë nga 13.264 burra dhe 1.851 gra ose vetëm 125 e pensionit mesatar (të tërësishëm) bujqësor është marrë nga gra të cilat punojnë në bujqësi. Nga ana tjetër, gratë kanë tendencë të dominojnë midis marrësve të pensionit bujqësor minimal.





Në e hyrë e theksuar për amvisëritë rurale është siguruar nëpërmjet subvencioneve që lidhen me prodhimtarinë bujqësore, që nuk është rast me amvisëritë të cilat jetojnë në mjediset urbane. Gjatë trajtimit të çështjeve gjinore (burrat dhe gratë rurale), hulumtimi i Qendrës për Hulumtim dhe Krijim të Politikave në vitin 2011, raportet për faktin se në shumicën e rasteve, gratë në mjediset rurale janë të privuara nga çdo lloj e hyre, përkatësisht 58% e të gjitha grave rurale nuk marrin të hyra personale, që është dy herë më tepër se burrat në zonat rurale dhe njëkohësisht gratë nuk janë pronare tokës dhe pronës, sipas traditës ajo u takon vetëm burrave ose vëllezërve. Të hyrat personale mesatare të llogaritura për burrat është 8.873 denarë, kurse gratë marrin më pak se gjysma e kësaj shume - 3.890 denarë. Përveç kësaj, një përqindje ngaft më e madhe e burrave dëshmojnë një pavarësi më të madhe sesa gratë rurale (burra 73% gratë 41%).

Republika e Maqedonisë tradicionalisht karakterizohet si shtet bujqësor, me rreth 44% të popullatës (985.000) që jeton në zonat rurale. Pjesëmarrja e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit në vlerën e përgjithshme të shtuar bruto është 10% në vitet e fundit. Ka 192.675 ferma të regjistruara në vitin 2007, kurse ky numër është zvogëluar në 170.900 ekonomi bujqësore në vitin 2013. Si dhe shumë shtete ballkanike në vendet post-socialiste, pjesa më e madhe e ekonomive bujqësore futen në grupin e fermave të vogla individuale (99%) me rreth 58% e tyre me ferma me madhësi deri në 1 ha në


UAA; ose 87,6% e fermave deri në 3 ha. Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar është zmadhuar me 315 900 ha, kurse me të zmadhohet edhe sipërfaqja mesatare për mirëmbajtje në 1,9 ha, në vitin 2013. Pothuajse se gjysma e fermave janë specializuar në prodhimin e kulturave ose në prodhimtarinë e përzierë (bimore dhe blegtorale). Për shkak të këtij procesi të ngadalshëm të konsolidimit të fermave, bujqësia e vogël dhe përdorimi i joefikas i faktorëve të prodhimit, bujqësia e Maqedonisë sfidohet nga faktori i ulët i produktivitetit (duke përfshirë punën). Sipas strukturës së fermave bujqësore dhe madhësisë së tyre ekonomike, gjysma e fermave në vend (84,740 pronat ose 49.6% e numrit të përgjithshëm të fermave) kanë të ardhurave prej më pak se 2,000 në vitin 2013, e cila e kombinuar me grupin tjetër të madhësisë ekonomike (të ardhurat 2000 -4000 euro) është rritur për 118,396 ferma ose në afërsi të 70% të të gjitha fermave. Vetëm 0.4% e fermave kanë një madhësi ekonomike nga 25,000 deri në 50,000 euro. Mesatarisht njësia për bagëti, për fermë ishte 2.14 në vitin 2013. Numri i bagëtive ka një trend ngaft i qëndrueshëm gjatë periudhës 2005-2015, një mesatare prej 252,000 kokë bagëti, zvogëlimin e numrit të lopëve qumështore në periudhën 2008-2009. Mbi 95% e prodhimit të qumështit është prodhuar nga ekonomitë bujqësore individuale edhe përkrah kushteve të përshtatshme gjeografike-klimatike, blegtoria tregon trend të rënies, me një rritje modeste në vitin 2010, trendi lëviz teposhtë si rezultat i mënyrë intensive të mbarështimit të

deleve, si dhe migrimi i popullatës në mjediset urbane. Rreth 95% e deleve mbarështohen në amvisëritë bujqësore individuale dhe delet më shpesh ruhen në ferma individuale dhe të vogla me madhësi të tufës nga 20 deri në 200 dele.

Fuqia e gjatë e ulët blerëse e konsumatorëve në vendet e EJT nuk inkurajohet me miratimin e metodave moderne që respektojnë mjedisin, mirëqenien e kafshëve, kushtet e punës dhe sigurinë e ushqimit. Gjithashtu ka edhe ankesa se presioni mbi çmimet shkojnë dorë për dorë me praktikatat tregtare të padrejta, të tilla si pagesat e vonuara për fermerët. Përveç kësaj, lëvizjet e çmimeve në dhjetë vitet e fundit nuk ishin të favorshme për shumicën e fermerëve, duke i vendosur prodhuesit primarë bujqësorë në një pozicion të vështirë në aspektin e aktiviteteve të tyre ekonomike dhe të biznesit, si dhe standardin e tyre të jetesës. Ekonomia rurale në Maqedoni në përgjithësi përfaqësohet nga ndërmarrjet e vogla (duke përfshirë edhe ndërmarrjet mikro) që përqendrohen në veprimtarinë e tyre ekonomike në tregjet lokale dhe rajonale. Këto ndërmarrje janë kryesisht në prodhimin primar bujqësor, të vendosura kryesisht në zonat rurale. Niveli i ulët i integritimit vertikal është një problem serioz për procesin e prodhimit bujqësor në Maqedoni, i cili në shumicën e rasteve do të thotë mungesa e plotë të marrëdhënieve të dakorduara dhe rezultoi në pasiguri që pengon planifikimin afatgjatë, dhe shpesh çon në pabarazi në ofertë dhe kërkesë dhe shkatërrim të tregut. ●



Formim i pjerrët i sipërfaqeve pjellore



Shkruan: dipl. arg. Llambe Kucinovski

Përzgjedhja e sistemit të kultivimit përkatësisht formës së kurorës së pemës frutore janë faktorë të cilët kanë rëndësi kryesore për prodhimtari rentabile të mollës. Të gjitha format e kurorës ndahen në tri grupe themelore: forma natyrore, forma gjysmënatyrore dhe forma të dirigjuara ose artificiale, të krijuara nën ndikim të plotë të njeriut. Ato janë gardhe të gjalla ose roje, të cilat shpesh formohen me mbështetje përkatëse. Këtu futen format e kultivimit siç janë: thurje e fortë, super thurje, thurje e dyfishtë, sistem V i kultivimit të thurjes së fortë, solaks, dhe sistemit të kripur Y (Tatura sistem), thurje e dyfishtë etj. Me këto sisteme arrihet zhvillim i shpejtë dhe harmonik i pemëve frutore dhe në përputhje me kushtet dhe kërkesat natyrore të potencialit gjenetik të llojit. Gjithashtu, krijohet dhe sipërfaqe më e madhe dhe më pjellore e pemës frutore dhe renditje më e mirë e degëve. Pemët frutore prodhojnë dhe japin fruta me cilësi të mirë, kurse trungjet janë me rritje të vogël, për shkak të krasitjes së lehtësuar, vjeljes së frutave dhe masat e tjera agroteknike. •



Sistemi V për kultivim

Ky është sistem me formim të pjerrët të sipërfaqeve prodhuese e cila arrihet me mbjelle të pjerrët të fidanëve dhe kjo njëri pas tjetrit (një fidan nga njëra anë, tjetri nga ana e kundër e hapësirës ndërmjet radhëve). Mbjellja kryhet nën kënd të ndërmjetshëm prej 30° përkatësisht 15° përkundrejt vertikales. Ky sistem i kultivimit është në largësinë optimale për mbjellje (3,5-4 m x 0,5-0,80 m). Numri i trungjeve mund të lëvizë nga 1.480-2.970 pemë për ha në truall M9, përkatësisht 2.830-2.970 pemë për ha në truall M27. Sistemi formohet me konstruksion mbështetës dhe trungjet janë të larta 2 m. Ata lidhen me dy radhë me tel nga të dyja anët e radhës. Çdo filiz formohet si thurje e fortë e përkulur që është më e gjerë poshtë, kurse më e ngushtë sipër dhe është ndriçuar në mënyrë të përkryer nga të gjitha anët. Degët e dendura dhe vertikale që gjenden në pjesën e brendshme hiqen ose mbështillen në kohë. Pemët frutore japin prodhim shpejt, kurse në vitin 3-4 arrijnë prodhimtarinë e plotë. Këto sisteme të kultivimit mund të konsiderohen si sisteme me intensivitet të lartë dhe me profitabilitet të lartë vetëm në kushte të teknologjisë së mirë të kultivimit, përkatësisht gjatë zbatimit të të gjitha masave të domosdoshme agrare dhe pomoteknike. Ngritja e pemëtoreve të tilla nuk mund të përfytyrohet pa sistemin për ujtime, ushqimin e dozuar, pa rrjeta kundër breshrit dhe ndjekjen e kushteve kohore. Në këtë mënyrë investimet e mëdha kompensohen shpejt dhe është nxitje për intensifikimin e mëtejshëm të prodhimtarisë frutore.

Sistem Y i kultivimit (Tatura system)

Kjo mënyrë e kultivimit për herë të parë është zbatuar në Australi. Kërkimet janë kryer në lloje të dendura të cilat me sisteme vertikale mund të futen në rendiment të mirë. Largësia e mbjelljes midis radhëve është 4,5m, kurse në radhë deri në 1 m. Fidanët shkurtohen në 40-50 cm dhe formohen nga dy degë skelete të cilat më vonë përkulen midis radhëve në një kënd prej 60°, përkatësisht prej 30° përkundrejt vertikales. Në vitet e ardhshme degët skelet prej radhëve fqinje bashkohen dhe fitohet një tunel (konstruksion çati). Degët skelet lihen me pemën amë, kurse ato vertikale hiqen. Lartësia e çatisë është 2,5 m, ku lëvizin makineritë për mbrojtje, përpunim etj. Sistemi formohet me konstruksion mbështetës prej shtyllave të vëna me pjerrët me nga 5-6 tela në çdo anë. Konstruksioni është i shtrenjtë, por kompensohet nga rendimenti cilësor i cili është 30-50% më i madh në raport me mënyrat klasike të kultivimit.



Ushqimi i viçave

Shkruan: Eljica Beshliq

Një prej fazave më të ndjeshme të në blegtori është kujdesi dhe ushqimi i viçave. Në fermat bashkëkohore viçave u kushtohet vëmendja më e madhe. Viçat vendosen në bokse të veçanta në stallë që të zvogëlohet rreziku nga sëmundjet ngjitëse, kurse kështu edhe rreziku prej vdekshmërisë të viçat. Edhe përkrah faktit se viçat lindin me lukth me katër ventrikulë ata në fillim sillen si kafshë monogastrike. Me rritjen e viçit, kjo gjendje ndryshon dhe shkallë-shkallë funksioni themelor i tretjes së ushqimit e kryen mullëza.

Ushqimi i viçave kryhet në disa faza:

- Faza e ushqimit të lëngshëm,
- Faza kalimtare,
- Faza e ushqimit me ushqim të thatë, faza e ripërtypjes.

Faza e ushqimit të lëngshëm kufizohet në 60 ditët e para dhe ndahet në:

- Ushqim me kolostrum (5 – 7 ditë),
- Ushqim me qumësht apo zëvendësim deri në 5 javë,
- Ushqim i viçave deri në heqje prej qumështit (java e 8)

Rëndësi të veçantë për zhvillimin e duhur të viçave ka qumështi i parë i lopës - kolostrumi. Me të vendosen funksionet fillestare të tretjes dhe furnizimit me shumë materie të rëndë-

sishme mbrojtëse - imunoglobinë. Kolostrumi është shumë i rëndësishëm dhe për karakteristikat në vijim:

Është i pasur me energji, që është shumë e rëndësishme sepse ditët e para viçi nuk mund të konsumojë sasi të mëdha ushqimi;

- Është i pasur me proteina sidomos me gama-globulina për fitim të imunitetit;
- Është i pasur me vitamina të tretshme në yndyrë;
- Është i pasur me minerale, midis të cilave Mg i cili ndikon në mënyrë laksative;
- E pastron traktin digjestiv të viçit.

Kolostrumi jepet në javën e parë të jetës, kurse pastaj kalohet në qumësht me yndyrë të plotë ose me zëvendësues të qumështit. Sasia ditore e qumështit ndryshon dhe mund të arrijë deri në 12 kg/ditë, kurse te gjedhët femra nuk duhet të tejkalojë 6 kg në ditë. Ushqimi jepet dy herë në ditë me sasi të njëjta qumështi. Zëvendësimet për qumështin duhet të jenë ushqime të lehta për tretje: qumësht pluhur, miell soje apo liri, miell peshku, vaj peshku, vaj bimor dhe yndyra shtazore. Përzierjet e prodhuara në fabrikë kanë udhëzim për përdorim. Zakonisht 1 kg miell zëvendësues për qumështin hollohet me 9 kg ujë të valët, kështu fitohen 10 kg ushqim i lëngshëm zëvendësues për qumështin, i cili ka të njëjten vlerë si dhe 10 kg qumësht lope.

Kjo sasi e qumështit për zëvendësim në javët e para të jetës ka përbërje ushqyese për rritje trupore prej 1 kg në ditë. Në përputhje me nevojat, shpejtësia e rritjes së viçave mund të rregullohet edhe me dhënien e ushqimit me sasi të caktuara të qumështit apo të zëvendësuesit të qumështit.

Nga java e dytë e jetës viçave u jepet përbërje e koncentruar cilësore dhe e shijshme. Në moshë prej 4 muajsh mund të kalohet në koncentrat më të thjeshtë i cili është i harmonizuar me proteina dhe energjikisht me përmbajtjen e celulozës së kashtës. Rekomandohet që koncentratit të jetë në peleta për shkak se shpërhapet më pak dhe është më i lehtë për konsumim. Ushqimi kaba futet si vakt që në javën e parë, dhe duhet të jetë me cilësi të përkryer. Ai u jepet sipas dëshirës viçave, kurse koncentratit kufizohet në varësi nga moshja, rritja e planifikuar, kohëzgjatja e ushqimit me ushqim të lëngshëm dhe lloji dhe sasia e konsumimit të ushqimit kaba.

Përveç ushqimit gjatë rritjes së viçave duhet të kihet parasysh dhe higjiena dhe kushtet e qëndrimit të tyre. Në këtë fazë mund të ndodhin shumë sëmundje ngjitëse: inflamacion në mushkëri dhe diarre. Shpenzimet për këto sëmundje janë mjaft të larta. Përveç shpenzimeve për shërim, zvogëlohet dhe rritja ditore, ngadalësohet zhvillimi dhe harxhohet kohë për kujdes për viçat e sëmurë. ●

Java	Vjetërsia (ditë)	Numri i pijeve/ditë	Qumësht natyror apo zëvendësues qumështi (litra për pije)	Koncentrat (gr/ditë)
1	1 -3	3	Kolostrum	
	4 - 7	2	2,0	
2	8 - 11	2	2,2	15
	12 - 14	2	2,5	30
3	15 - 21	2	3,5	50
4	22 - 28	2	4,0	200
5	29 - 35	2	4,0	300
6	36 - 42	2	3,5	650
7	43 - 49	2	3,0	1000
8	50 - 56	1	3,0	1500

Luleshtrydhe në fuçi



Shkruan: Despina Kërstevska

Nëse keni dashur gjithmonë të kultivoni luleshtrydhe, por hapësira ju kufizon, mjafton që të siguronit ndonjë fuçi prej druri apo plastike ose ndonjë enë tjetër si saksit dhe të kultivoni në tarracën apo ballkonin tuaj. Luleshtrydhja është bimë shumëvjeçare e cila ka prodhim të bollshëm, sidomos në 3 vitet e para, kurse më vonë mund të mbillet me sukses. Domethënë, luleshtrydhet nxjerrin degëza, bimë të reja të vogla të cilat në vjeshtën e hershme mund të mbillen dhe vitin tjetër të japin prodhim.

Nëse i mbillni për herë të parë, siguronit filiza cilësorë dhe tokë të mirë, dhe në varësi nga hapësira më mirë është të mbillen në largësi prej 20 cm. Koha optimale për mbjellje është vjeshta e hershme por edhe pranvera, por jo më vonë se maji, sepse atëherë llojet e hershme fillojnë të mblidhen. Së pari nevojitet të sigurohet sasia e mjaftueshme e tokës pjellore apo kompostos në mes të fuçisë vendose një tubo me vrima për drenazh që të hiqet uji i tepërt, plehërimi të jetë pleh bagëtish, nëse ka mundësi.





Luleshtrydhet bëhen më mirë në vend me diell, kurse që të arrijmë qarkullim të mirë të ajrit, është e nevojshme të jetë larg murit rreth gjysmë metri. Rendi i parë janë hapjet anësore, me madhësi prej 4-5 cm, bëhen vrima në lartësi prej 20 cm nga baza e fuçisë, kurse vrima e fundit 20 cm nga tehu i sipërm i fuçisë. Vrimat anësore për fidanët nuk duhet të renditen njëra poshtë tjetrës, me qëllim që gjatë vegjetimit mos e pengojnë bimën tjetër. Në fuçi vendoset dhe një shtresë prej gurësh të thyer apo

çakall, që uji i tepërt të kalojë më lehtë nga vrimat në fund. Mbi këtë shtresë, vendoset shtresa me truall pjellor dhe të shkrifët ose kompostoja që duhet të vendoset deri në rendin e parë të vrimave dhe atëherë duhet të mbillen filizat e luleshtrydheve. Nëse nuk mund të gjeni fuçi mund të përdorni edhe kova plastike të vendosura njëra mbi tjetrën, por duhet të keni kujdes për drenazhimin e ujit me vendosjen e tubit plastik në mes të kovave, kurse paraprakisht duhet të keni hequr fundin e tyre.



Sot, kultivohen lloje të luleshtrydheve të cilat prodhojnë vazhdimisht dhe kanë fruta më të mëdha dhe quhen "sommambul" të cilat nuk janë produktive si llojet e tjera, por lulëzojnë vazhdimisht dhe japin fruta nga qershori deri në vjeshtë. Por, më të rejat në treg u shfaqën "llojet zvarritëse të luleshtrydheve" të cilat janë të përshtatshme për kultivim në kopshtet në ballkon. •

Ngjeshja dhe tejngjeshja e truallit

si problem i rëndë i bujqësisë bashkëkohore së mekanizuar

Ngjeshja e tokës si faktor aktual i cili ndikon shumë negativisht mbi prodhimtarinë e tokës dhe madhësinë dhe cilësinë e prodhimit.

Shkruan: Dipl. inxhi. bujq.
Vanço Zahariev

Vetë ngjeshja si proces përbëhet nga afrimi i qelizave të tokës dhe agregatet e tyre duke u zvogëluar kështu hapësira e lirë midis tyre e cila zakonisht është e mbushur me ujë dhe ajër. Shkaqet apo faktorët të cilët e përbëjnë apo prej të cilave varret shfaqja e ngjeshjes dhe prirjes së tokës ndaj kësaj mund të jenë edhe më tepër se kjo së pari tekstura (përbërja mekanike) e truallit kështu që tokat të cilat përmbajnë më tepër glinë janë më të ndjeshme ndaj ngjeshjes prej atyre që përmbajnë pluhur dhe rrëre.

Mbilagështia çon gjithashtu në formimin e kores dhe ngjeshjes së tokës. Lërimi i tepër e shkatërron gjithashtu strukturën e tokës dhe shfaqet ngjeshja e saj. Por shkaktari kryesor dhe aktual i ngjeshjes janë presioni dhe rrëshqitjet e gomave të traktorëve dhe mekanizmave të tjerë që përfshihen në procesin e prodhimtarisë bujqësore. Çdo kalim i mekanizmave gjatë kryerjes së masave të nevojshme agroteknike gjatë kultivimit të kulturave bimore është shprehur nëpërmjet veprimtarisë së tensioneve të pazakonshme dhe të padurueshme të rrotave mbi shtresën e tokës të cilat si të tilla deri në shfaqjen e mekanizimit nuk kanë qenë kurse me këtë edhe problemi i cili si i tillë është vënë re dhe merren masa për lehtësim apo largim të veprimeve dhe pasojave të tij. Nga kërkimet është vërtetuar se mekan-

izimi shkakton 4 lloje të ngjeshjes së tokës:

1. sipërfaqësore;
2. të thellësishme;
3. rrëshqitëse;
4. ngjeshje nga rrotat; dhe
5. ngjeshje e quajtur gjon plugu.

Sipërfaqësore është kur ka ndodhur në thellësi prej 15 cm. E njëjta shkaktohet nga presioni i gomave të mekanizmave.

Ngjeshje e thellësishme ndodh nga 15 cm e më poshtë deri në 70 cm thellësi dhe shkaktohet nga pesha gjithnjë dhe më e madhe e trupit të makinerive mbi boshtet e makinerisë.

Ngjeshja e tokës nga rrëshqitja ndodh kur zhvillohet transferimi i jopërkatesë i fuqisë së motorit mbi boshtin e rrotave përkatësisht përkundrejt rezistencës përkatëse ku rrotat e boshtit vërtiten përkohësisht apo vazhdimisht duke ushtruar presion shtesë mbi truall duke ndikuar mbi të duke kryer ngjeshje dhe shkatërrim të shtresës së truallit ku kalon rrota.

Ngjeshja nga rrotat shkaktohet nga gomat e rrotave të dyfishta apo të trefishta gjatë së cilës shtresa e truallit midis dy gomave është e pasqyruar në trysni të madhe dhe shkatërrim deri në thellësi më të madhe.

Ngjeshja e quajtur gjon plugu shkaktohet gjatë lërimit të truallit në të njëjtën thellësi ku me kalimin e kohës shtresa e tokës që është nën atë thellësi ngjishet.

Llojet e ndryshme të tokave në varësi nga shumë faktorë dhe shkaktarë në mënyrë të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme janë të pasqyruar ndaj ngjeshjes. Është vërtetuar se tokat e përbëra prej teksturës së njëtrajtshme (madhësi e njëjtë e qelizave të tokës) dhe me sasi më të madhe të materies organike ngjishen më me vështirësi se ato të cilat nuk kanë teksturë të njëtrajtshme dhe materie organike. Gjithashtu, tokat më të lagështa janë më të përshtatshme për ngjeshje. Sepse për tokë pjellore konsiderohet ajo e cila gjysma përbëhet nga një pjesë e fortë, kurse gjysma tjetër është e rezervuar për pranimin e njëtrajtshtëm të ujit dhe ajrit.

Çdo kalim i mekanizimit nëpër tokë e shkatërron këtë gjendje sepse nën veprim të presionit hapësira për ujë dhe ajër zvogëlohet në masë më të madhe apo më të vogël, kurse me këtë edhe kushtet për zhvillim të mirë të kulturës së kultivuar.

Tokat të cilat kanë arritur nivelin e ngjeshjes dhe tejngjeshjes dallohen nga fakti se në ato toka pas shirave të shumta formohet kore, uji i rënë qëndron më gjatë në sipërfaqen e tokës (përçim i vogël i ujit), erozioni (mbartja-shpërndarja) e tokës është më e madhe, shpërbërja e materies



organike është më e vogël, të mbjellat mbijnë më ngadalë, porë në sipërfaqe vihet re rritje jo e njëtrajtshme, zbehje dhe mungesë e ngjyrës në gjethe, deformim i masës së rrënjës, lërimi kryhet më me vështirësi dhe në mënyrë jo të njëtrajtshme dhe pjesët e trupit të plugut amortizohen më shpejt. Është vërtetuar se ngjeshja e thellësishme e truallit e shkaktuar nga mbingarkeja e madhe sipas boshtit ndikon mbi zvogëlimin e të ardhurave të kulturave deri në 30%. Sipas njohurive të shpallura nga kërkimet në SHBA në varësi nga shkalla se deri ku ka ndodhur ngjeshja dhe lloji i kulturës që kultivohet humbjet në të ardhura mund të arrijnë edhe deri në 60%. Disa kultura janë më të ndjeshme ndaj ngjeshjes së tokës, apo më pak të ndjeshme, por në përgjithësi mbi të gjitha ndikon negativisht në prodhim. Gjithashtu, sa më e thellë është e ngjeshur toka aq më gjatë do të ndjehet ndikimi negativ mbi kultivimin e kulturave bimore. Siç është përmendur edhe më parë nga momenti kur kanë filluar të vihen re ndikimet negative nga ngjeshja e tokës, ka filluar edhe modernizimi i mekanizmit me qëllim që të zvogëlohet kjo dukuri destruktive. Kështu sot shumica e makinerive më të rënda kanë rrota të njëfishta (jo të dyfishta) me sipërfaqe të gjerë të shkeljes ose me bosht gome si më i përkryeri deri tani dhe presioni mbi tokë është shndërruar në minimum. Gjithashtu përcjellja dhe ndryshimi i fuqisë së motorit deri në pjesën e lëvizjes (rrota, zinxhir) është automatik, i robotizuar është bërë kontribut i madh në zvogëlimin e rrëshqitjes së pjesës



së fuqisë lëvizëse (rrota, zinxhirë) dhe dëmet të cilat janë shkaktuar sidomos nëpërmjet konsumit të karburantit dhe ngjeshjes së tokës. Gjithashtu, është vendosur pajisje naviguese me të cilën mundësohet lëvizje e planifikuar dhe e organizuar e mekanizmit nëpër sipërfaqen bujqësore me qëllim që të zvogëlohet ngjeshja e tokës. Përkrah faktit që mekanizmi është gjithnjë dhe më modern dhe jep kontribut të madh në zvogëlimin e ngjeshjes së tokës si dhe njohuritë se ajo ka aftësi për vetëpërtëritje e cila nuk është e mjaftueshme për kontrollim të ngjeshjes së tokës dhe shndërrim deri në minimum praktik është e nevojshme ndërmarrja e një numri të caktuar të masave agroteknike dhe organike.

Si masa të cilat duhet të ndërmerren për largimin e kësaj dukurie negative janë:

➤ organizimi i renditjes ku do të mbillen bimë shumëvjeçare leguminoze (jonxhë, tërfil) dhe kultura foragjere drithëra (Dactylis glomerata - telishi, Bromus secalinus - bromus, Lolium italicum(multiflorum) - lolium). Gjithashtu është e dobishme dhe hedhja e plehrave organike dhe mbetjeve bimore. Që të mos arrihet te kjo dukuri apo që të hiqet q ash-tuajtura ngjeshje gjon plugu si dhe llojet e tjera të ngjeshjeve është e nevojshme numri i lërimit të tokës të jetë në minimum dhe të ndryshohet më shpesh thellësia e lërimit, kështu që në kushte kur toka është pak më e thatë lërimi të jetë më i thellë.

➤ Për zvogëlim apo largim të ngjeshjes së tokës (sipërfaqësore, gjon plugu, të thellësishme) janë kryer pajisje të reja për lërim dhe prashitje të cilat gjithnjë dhe më tepër prano-hen dhe përdoren për lërim të thellë e cila zakonisht si operacion duhet të kryhet në vjeshtë në toka më të thata ku në kushte të tilla toka shkrirohet dhe ristrukturohet më thellë duke shkuar në drejtim të përmirësimit të strukturës së saj dhe kapaciteteve kimike-fizike, kurse kështu largohet pjesërisht ngjeshja si dukuri.

➤ Gjithashtu, shkenca propozon gjithnjë dhe më tepër praktika midis të cilave janë mbjellja e drejtpërdrejtë, zbatimi i përpunimit të reduktuar të tokës dhe lëshimi i lërimit apo minimizimi i ti ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e tokës dhe mjedisit natyror nga ndikimet e shumta negative midis të cilave dhe ndikimi i mekanizmit gjithnjë dhe më të rëndë i cili përfshihet në procesin e prodhimitarisë bujqësore. •



Kuvendi i Përgjithshëm i FFRM-së: Subvencionet e bujqve, dëmet nga ngrica pranverore duhet të paguhen

Federata e fermerëve të RM-së e mbajti Seancën vjetore të Kuvendit të Përgjithshëm të FFRM-së më 27.04.2017 ku morën pjesë delegatë të organizatës. Në këtë Seancë mbajti fjalim edhe kryetari i FFRM-së, Nikolla Stamenov, duke theksuar se pikat më të dhimbshme, edhe mandej, në bujqësi janë plasmani dhe prodhimtaria e dakorduar. Prandaj është me rëndësi të veçantë ishin subvencionet sepse pikërisht problemet me çmimet e ulëta blerëse vetëm sa i kanë zmadhuar shpenzimet e bujqve, kurse të ardhurat kanë mbetur shumë të vogla. Ai bëri thirrje që të mos bëhen premtime për afate të cilat nuk mund të përmbushen dhe Qeveria duhet të gjejë zgjidhje ligjore për t'i ndihmuar bujqit me pagimin e subvencioneve.

“Goditje e veçantë këtë vit është bërë mbi blegtorinë, pemëtarinë dhe vreshtarinë dhe kopshtarinë për shkak të përmytjeve të vjetshme, prej temperaturave të ulëta në periudhën e dimrit dhe ngrica pranverore e tanishme e cila i rrënoi krejtësisht vreshtat dhe pemishtet nëpër gjithë shtetin. FFRM-ja nëpërmjet dhënies së këshillave për bujqve dhe lidhjen e tyre me ekipet profesionale dhe komunale për kryerjen e vlerësimit të dëmeve u përpoq të ndihmojë për problemin e tillë. Me vite me radhë



apelojmë dhe dëshmojmë se ndryshimet klimatike do të bëjnë probleme të mëdha në bujqësi dhe këtë tashmë po e ndiejmë. Në shtet duhet të përpilohet Strategji për ballafaqim me ndryshimet klimatike prandaj edhe njëherë ju bëjmë thirrje fermerëve në këtë periudhë t'i paraqesin dëmet e veta, të bëhet zhdëmtim sa më i shpejtë nga shteti dhe kompanitë e sigurimit, mjetet e vjetshme për dëmet të paguhen gjithashtu”, theksoi në fjalimin e vet Stamenov. Ai bëri thirrje për bashkim të fermerëve dhe me fuqi të bashkuara t'u kundërvihemi sfidave të cilat na presin dhe të mos lejojmë çfarëdolloj manipulimi ta tejkalojë vlerën tonë për shkak të qëndrimeve dhe interesave të ndryshme personale.

Këtu u bëjmë thirrje partive politike në shtet t'i lënë suetat e veta, interesat individuale dhe të shikojnë me të vërtetë se çfarë po ndodh shtet, se të gjithë thjesht po mbytemi. Duhet t'i vihet fundi krizës politike dhe nëpërmjet dialogut për interesin e të gjithëve në shtet të gjejnë zgjidhje dhe të vihen në funksion institucionet e sistemit”, theksoi Stamenov.

Gjatë mbajtjes së kuvendit janë ndarë fletëlavdërimi për profesorët Tatjana Mitkova, Mile Markovski, Dragi Dimitrievski nga Fakulteti Bujqësor dhe Ivan Blenkov nga Fakulteti i Pylltarisë për përgatitjen e Udhëzuesit praktik dhe masave për sanim të tokave në zonat e përmytura. Udhëzuesi është botuar vitin



e kaluar nga FFRM-ja, kurse me mbështetje të fondacionit suedez We Effect me qëllim që të ndihmohen bujqit e përfshirë nga fatkeqësitë elementare; Profesoreshës Emel Tuna nga Fakulteti i Bujqësisë për përgatitjen e Analizës mbi varfërinë në Republikën e Maqedonisë me theks të veçantë mbi varfërinë rurale, në bashkëpunim me FFRM-në.

Fletëlavdërimi i është dhënë edhe Asociacionit Maqedonas për Kooperativat Bujqësore për bashkëpunimit të realizuar vitin e kaluar me FFRM-në në implementimin e aktiviteteve në drejtim të ndryshimit të Ligjit për Kooperativat Bujqësore dhe realizimin e programit të përbashkët edukativ dedikuar kooperativave bujqësore, ku janë përgatitur 6 plan-biznesi dhe janë realizuar trajnime për planifikim biznesi, strategji marketingu dhe komunikim afarist.

Kooperativa bujqësore “Eko Ilinden”, prof. dr. Ljubica Karakashova, Stojan Gligorov kanë marrë fletëlavdërimi për zbatimin e aktivitetit për fokus grupin në kooperativën “Eko Ilinden” mbi prodhimtarinë e perimeve organike dhe reçelin e parë prej karotash ekologjike.

Shoqata e Pemëtarëve “Bllagoj Kotllarovski”, anëtare e FFRM-së për realizimin e takimit midis pemëtarëve të rajonit të Prespës nga Resnja dhe Korça në drejtim të evenimentit të përbashkët të tregjeve dhe bashkëpunimin e përbashkët ekonomik.

Rrjetit të Grave Fermere i FFRM-së për kontributin e veçantë të dëshmuar në zbatimin e aktiviteteve në drejtim të përforcimit të Rrjetit dhe zmadhimin e numrit të grave fermere të anëtarësuar në FFRM-në.

FFRM-ja ka i ka dhënë fletëlavdërimi edhe organizatës suedeze We Effect mbi bashkëpunimin trevjeçar, me të cilin nëpërmjet projektit institucional “Mbështetja institucionale e FFRM-së” zbatohen aktivitete në drejtim të përmirësimit të bujqësisë së përgjithshme dhe përmirësimit të klimës së agrobiznesit, me shtim të vlerës mbi rëndësinë e bujqve.

Në Kuvendin e Përgjithshëm u shqyrtuan raportet financiare për vitin 2016 dhe 2017 dhe planet për aktivitetet e realizuara në vitin 2016 dhe planin e aktiviteteve për vitin 2017. Kryesuesi i Kuvendit të FFRM-së ishte Vanço Kirovski. ●

Gratë fermere të trajnuara për transferimin e të fidanëve të rrushit nga stratifikimi në fushë



Është organizuar trajnim praktik në fushën me fokus grupin në fshatin e Negotinës, Timjanik për fidanët e rrushit nga stratifikimi në fushë. Fokus grupi është krijuar nga 10 gra fermere të cilat përvojën e fituar do të zbatojnë për kompensimin e caktuar financiar prej kompanisë bujqësore Agro Kalem, e cila prodhon fidanë frutash dhe rrushi. Trajnimi është realizuar nga prof. dr. Klime Beleski i cili ua prezantoi praktikisht procesin, hap pas hapi, me këshilla se si punohet dhe ku duhet të fokusohen për manipulimin e drejtë me fidanët

nga nxjerrja deri te stratifikimi dhe te ruajtja e tyre. Ai theksoi se me rëndësi të veçantë është edhe temperatura e dyllit i cili përdoret për fidanët që të merren më tepër fidanë të klasës së parë, të cilët janë kërkuar më tepër në tregun e materialit mbjellës. Aktiviteti mbështetet nga projekti “Mbështetja Institucionale e FFRM-së” me mbështetje të We Effect dhe ka për qëllim t’i ndihmojë bujqit e vegjël që të veprojnë bashkërisht dhe të bashkëpunojnë me të zhvillohen ekonomikisht me spektër të veçantë mbi gratë prej mjediseve rurale. ●

Puna me gratë fermere të vogla dhe të varfra – prioriteti ynë

Koordinatori nacional me koordinatorët rajonale të Rrjetit të grave fermere të FFRM-së mbajti mbledhje ku u bisedua mbi aktivitetet dhe prioritetet për vitin 2017. Edhe mandje do të punohet me fokus grupet

me gratë fermere të vogla dhe të varfra me qëllim që të çojë në përforcim të tyre, shënimi i Ditës ndërkombëtare të gruas rurale, organizim i evenimentit të petkave në terren nëpërmjet shkëmbimit të përvojave grua me grua. ●





Trajnim i anëtarëve të Klubit të Integruar të Mollës në drejtësi sëmundjet dhe dëmtuesit dhe t

Skruan: Nikolin Karapanci

Prodhimi dhe zhvillimi i biznesit dhe sidomos rritja e ndërgjegjësimit të fermerëve drejt arritjes së standardeve të Bashkimit Evropian për ruajtjen e shëndetit të konsumatorit dhe mbrojtjen e mjedisit është një nga komponentët kryesorë të projektit “Zhvillimi i Komunitetit Rural nëpërmjet Shoqatave të Fermerëve” të cilin AgriNet Albania është duke e implementuar me mbështetjen e We Effect, Suedi, në rajonet Korçë, Elbasan dhe Dibër.

Për të arritur këto standarde të prodhimit nevojitet një gamë e gjere teknologjike ku një vend të veçantë

zë mbrojtja e bimëve (mollës) nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të ushqyerit e saj. Në këtë kuadër u zhvillua një trajnim profesional në ambientet e një nga kompanive më të njohurat që operon në Shqipëri për shpërndarjen e produkteve që shërbejnë për mbrojtjen e nga sëmundjet dhe dëmtuesit dhe të ushqyerit e bimëve me anëtarë të Klubit të Prodhimit të Integruar të Mollës kryesisht nga rajoni i Korçës.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte njohja me preparatet bashkëkohore të mbrojtjes nga sëmundjet dhe dëmtuesit dhe të ushqyerit e bimëve, njohja me skemat më të përshtatshme të aplikimit të preparateve mbrojtës





ubit të Prodhimit tim të mbrojtjes nga të ushqyerit e mollës



por dhe atyre ushqyes si hallkat më të rëndësishme të teknologjisë së Prodhimit të Integruar në Mollë për mbrojtjen e shëndetit të prodhuesit, konsumatorit dhe ruajtjen e mjedisit.

Grupi i vizitoreve i përbërë prej 51 fermerësh u prit në ambientet e kompanisë nga administratorët dhe njëkohësisht specialistë në drejtimin e mbrojtjes së bimëve z. Masar dhe Bujar Huqi. Zotërinjtë në fjalë prezantuan para vizitoreve të gjithë historikun e krijimit, zhvillimit dhe ndikimit të kësaj kompanie duke theksuar faktin e afërsisë me eksperiencën bashkëkohore të vendeve të BE në drejtim të mbrojtjes nga sëmundjet dhe dëmtuesit dhe të ushqyerit e bimëve.

Gjithashtu ata bënë një pasqyrë të plotë për disa nga çështjet më kryesore si:

- Njohja e produkteve kryesore për mbrojtjen e mollëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit;
- Njohja e produkteve kryesore për të ushqyerit e mollëve;
- Skemat më të përshtatshme dhe më rezultative të kombinimit të preparateve për mbrojtjen dhe të ushqyerit e mollës;
- Përdorimin racional të këtyre preparateve për të mbrojtur shëndetin e prodhuesit, konsumatorit dhe ruajtjen e mjedisit.

Në shoqërimin e specialistëve u realizuan dhe një vizitë në ambientet e ruajtjes dhe të magazinimit të produkteve në fjalë si dhe duke pasur pyetje dhe diskutime rreth produkteve të magazinuara dhe për sa u fol në seancën trajnuese, tek vizitorët u krijuan përshtypje pozitive rreth besueshmërisë dhe programeve të aplikimit të tyre që në fund prodhimi të jetë i garantuar, pa ngarkesa të dëmshme për jetën e njerëzve dhe ndotjen e mjedisit. •

Barazia gjinore dhe gr

AgroPuka po zbaton nga nëntori 2011 dhe në vazhdim projektin “Të kontribuojmë në përmirësimin e Qëndrueshëm të kushteve të jetesës së popullsisë rurale në rrethin e Pukës”, mbështetur dhe financiar nga We Effect (SCC)-Suedi.

Shkruan: Sabah Djaloshi

Projekti ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së grupeve të synuara duke marrë masa që çojnë në rritjen e të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen. Projekti identifikon dhe promovon modelet e bashkëpunimit në fushat e prodhimit dhe marketingut, barazisë gjinore, pjesëmarrjes dhe demokracisë në nivel lokal.

Në fazat e Projektit aktivitetet janë orientuar më tepër drejt mbështetjes të grupeve të synimit: Anëtarët e AP, prodhuesit që prodhojnë produkte cilësore dhe i shesin ato me ndihmën e marketingut të AP, gjashtë grupe interesi të grave, të cilët përmes kontributeve të tyre ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes sociale dhe ekonomike të grave në rrethin e Pukës. Projekti ka mbështetur dy grupet tematike:

- të prodhimit të djathit të dhisë dhe;
- grupin e bimëve aromatike dhe frutave të pyllit si dhe ka kontribuar duke mbështetur aktivitetet të Shoqatës së Bletarëve Pukjanë.



BARAZIA GJINORE DHE PËRFORCIMI I GRAVE NË RRETHIN E PUKËS

Edhe për krah faktit se aktivitetet përfshijnë më tepër grupe të synimit për Barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave janë mobilizuar mbi 50% të të gjitha burimeve të projektit. Në lidhje me komponentin e barazisë gjinore u zhvilluan shumë aktivitete:

Baza e të dhënave ka qenë udhëzues në të gjitha aktivitetet për matjen e rezultateve. Stafi Menaxhues i projektit ka ndjekur nga afër Strategjinë Gjinore të Agropukës dhe Strategjinë Gjinore të We Effect, gjithashtu.

atë në rrethin e Pukës



Projekti ka kontribuar në zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve për modulet e mëposhtme:

- a) Barazia gjinore;
- b) Buxheti gjinor;

c) PL- anifikimi me bazë gjinore duke tra- jnuar 10 trajnere (ToT) të cilat kanë replikuar njohuritë me anëtarët e tjerë dhe grupet e komunitetit në zonën e tyre.

Trajnimet për buxheti- min gjinor dhe planifikimin me bazë gjinore janë zhvilluar edhe me stafin e bashkive Pukë dhe Fushë-Arrëz, institucionet lokale, bashkëpunë- torët, stafin e Agropukës, Bordin si dhe OJQ-të që zbatojnë projekte në Pukë.

Gjithashtu, Agropuka ka zhvilluar tri manuale praktike në fushën e formimit profesional për ofrimin e trajnimeve për grupet e grave dhe gra të tjera të interesuara për: a) Gatimi me produkte vendore ku 11 gra të reja janë trajnuar në Shkodër në Shkollën e Formimit Profesional (Shkollë Salesian në Shkodër). Pas trajnimit ata e kanë replikuar pro- gramin me 3 grupe të grave në Pukë, Gjegjan e Qerret. b) Moduli për përpunimin e qumështit ku një grup nga AP ka marrë trajnim në

Tiranë në Qendrën e Transferimit të Teknologjisë dhe pastaj kanë replikuar njohuritë me 5 grupe grash në Gjegjan, Blerim, Pukë, Qerret dhe Iballe; c) Moduli i kooperimit ku janë trajnuar tre grupet e grave në Qelzës, Qerret dhe Gjegjan. Grupi Qerret ka shprehur vullnetin për të vazhduar me procesin e formalizimit.

NË FAZAT E PROJEKTIT JANË MBËSHKETUR GRUPET E GRAVE NËPËRMJET:

- a) Trajnimeve të ndr yshme në fushën e barazisë gjinore, përpunimit të frutave dhe perimeve, kultivimin e varieteteve lokale, marketingun e produkteve, etj.
- b) Har timin e planit të biznesit etj.;
- c) Demonstrime në fushën e prodhimit, mbledhjes, përpunimit dhe marketingut të produkteve vendore;
- d) Pjesëmarrje në aktivitetet lokale dhe kombëtare, siç janë :
 - konferenca bujqësore në Ministri- në e Bujqësisë në Tiranë,
 - tr yezat e rrumbullakëta në Pukë etj.;
 - pjesë- marrje në panaiet lokale dhe ditët e tregut, në panaire kombëtare si:
 - Terra Madre, etj. panaire rajonale në Pukë, Shkodër etj.;
- e) Promovimi i grupeve dhe aktiviteve të tyre përmes mediave lokale dhe mediave kombëtare si Top Channel, News 24;
- f) Shkëmbime të përvojave brenda fshatit me fermerë të tjerë, grupet me njëri-tjetrin, jashtë rrethit me organizata të tjera par tnere etj.;
- g) Rrjetëzimi me projekte dhe organizata të tjera si RTM, Federata e Pyjeve dhe Kullotave, Hapa të Lehtë, etj.;
- h) Mëshetje për aktivitetet sociale dhe kulturore me rastin e 7-8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale dhe Ditës Ndërkombëtare të Ushqimit etj.;
- i) Krijimi i një biblioteke në zyrat e Agropukës për gratë ku ata kanë mundësinë për të marrë njohuri të reja në fushat që ata kanë interes. •



Ngricat e vonshme gjatë



Shkruan: Ardianë Lecaj & Ilir Gashi

Gjatë viteve të fundit, ngricat e vonshme pranverore nuk janë të rralla. Qysh me fillimin e vegjetacionit të bimëve në pranverë, Kosova po befashohet nga temperaturat e ulëta dhe nga ngricat e vonshme pranverore të cilat po shkaktojnë dëme të konsiderueshme në kulturat e ndryshme bujqësore. Më të prekurat apo më të ndjeshmet janë kulturat pemëtare si ato farore, bërthamore, kultura e dredhëzës, bimët të cilat janë në fazën e lulëzimitit si dhe frutat e sapoformuar.

Nëse temperaturat e ulëta gjatë natës lëvizin nga -0.4 deri -5 gradë Celsius në kohëzgjatje mbi një orë atëherë shkaktohen dëme te lulet dhe frutat e sapoformuar.

Përdorimi i produkteve antistres për trajtimin e bimëve kundër dëmeve që mund të shkaktojnë ngricat, nëse përmishtet janë të ekspozuara nga ndikimi i këtyre ngricave dhe ka rrezik ka mundësi që të zvogëlohet rreziku me përdorimin e produkteve antistres. Përdorimi i këtyre produkteve është si masë parandaluese me përbërës që si bazë kanë aminoacidet organike (Biostimulues organik), që gjenden në formë të lëngjeve siç janë: Cumaks, Fitoalgen, Polifonik-amine, Trajner, Algovital etj.



Në muajit prill në Kosovë



Foto të marra nga tereni

Nëse trajnimet me biostimulator organik nuk janë bërë në kohën e duhur dhe supozohet që janë shkaktuar dëme nga ngricat atëherë më mirë është që të mos përdoren fare këto produkte pasi që nuk e kanë efektin e dëshiruar, sepse organet gjeneruese të bimët veçse janë dëmtuar.

Në qoftë se fermerët nuk kanë përdorur biostimulatorët, masat mbrojtëse që mund të ndërmerren janë: duke i ujitur pemishtet në formë shiu si dhe duke i tymosur me anë të djegies së ballave të kashtës për të krijuar një mikroklimë e cila nuk do të lejonte shkaktimin e dëmeve nga ngricat.

Duhet që të bëhen monitorime të vazhdueshme të pemishteve dhe nëse kemi rënie të temperaturave afër 0°C duhet të merren menjëherë këto masa që u cekën .

Lidhur me atë se a do të kompensohen fermerët e prekur, sipas Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural thuhet se do të bëhet një kompensim i pjesshëm pasi që për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ka të dedikuara diku 500,000 euro.

MBPZHR është duke pritur raportet vlerësuese nga drejtoritë komunale të bujqësisë për të kuptuar vlerën e dëmeve të shkaktuara nga temperaturat e ulëta në prill të 2017. •



FFRM



FFRM-ja i organizon dhe bashkon fermerët në nivel nacional, me qëllim të përbashkët që të zgjidhen problemet dhe të përmirësohet prodhimtaria në bujqësi dhe zhvillimi rural në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi kryesor është të jetë organizatë moderne, transparente dhe demokratike e fermerëve e cila është e njohur në nivel nacional dhe i njeh dhe bashkon pjesën më të madhe të bujqve, i përfaqëson dhe i mbron interesat e tyre dhe vepron në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të prodhimit bujqësor dhe rajonet rurale në përputhje me nevojat reale të bujqve në Republikën e Maqedonisë. FFRM-ja vepron në nivel nacional, në përputhje me nevojat dhe nevojat e anëtarëve të vetë. Si model i strukturuar hapëron sipas gjurmëve të bujqve suedeze me nënshkrim të marrëveshjes për bashkëpunim me Federatën Suedeze të Fermerëve. Mbi 10.000 njerëz janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte të përfshira në organizatë, domethënë: si anëtarë të organeve të menaxhimit, të punësuarit, vullnetarët, pjesëmarrësit në trajnime për punëtori edukuese, pjesëmarrësit në udhëtimet studimore jashtë shtetit,

në organizimin e panairove dhe shumë formave të tjera. Përveç kësaj, realizohet bashkëpunim intensiv me organizata nga rajoni, siç janë Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Rumania, Sllovenia si dhe me organizata nga shtetet evropiane siç janë Suedia, Franca dhe Holanda. Një prej mjeteve më efikase të FFRM-së për informim dhe edukim është revista e saj mujore "Toka ime" e cila është e vetmja revistë mujore në Republikën e Maqedonisë e cila jep komentet dhe mendimet e bujqve, ekspertëve dhe institucioneve relevante, raporte, këshilla edukuese dhe analiza. Në drejtim të zhvillimit të fermerëve të vegjël, bashkëpunimit rajonal dhe kooperativave, FFRM-ja filloi me realizimin e projektit "Zhvillimi institucional i FFRM-së" i cili realizohet në bashkëpunim me organizatën suedeze We Effect.

AGROPUKA



AGROPUKA është një shoqatë e prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë të rrethit të Pukës (Shqipëria e Veriut). Ajo është krijuar në 2001 me mbështetjen e Bashkëpunimit për Zhvillim të Zvicrës (SDC). Që nga ajo kohë, shoqata ka rritur anëtarësinë e saj dhe ka zgjeruar aktivitetin dhe shërbimet, për të plotësuar nevojat e anëtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Shoqata kontribuon në zhvillimin e integruar rural nëpërmjet inkurajimit dhe promovimit të zhvillimit ekonomik si dhe të iniciativave dhe veprimtarive për të përmirësuar jetesën e anëtarëve të AP dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë mënyrë AP ndikon në reduktimin e varfërisë dhe padrejtësive sociale në zonat rurale.

Nga viti 2011, Agropuka po zbaton projektin "Të kontribujmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetës së banoreve të zonave rurale të Pukës" që financohet nga We Effect (Suedi).

Projekti është në fazën e dytë të tij (2014-2016; faza e parë u zbatua gjatë 2011-2013) dhe synon përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimit të demokracisë dhe pjesëmarrjes lokale.

Në tre vitet e ardhshme shoqata do të përqendrohet në tre fusha: (1) Përmirësimin e kushteve të jetesës së anëtarëve të AP dhe të komuniteteve në zonat ku punon AP nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit, marketingut, dhe modeleve të kooperimit; (2) Promovimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; dhe (3) Promovimin e demokracisë lokale dhe përfshirjes sociale të komuniteteve rurale në vendim-marrjen lokale. Për këtë Agropuka do të rrisë qëndrueshmërinë, përgjegjësinë dhe kapacitetin organizativ të saj.

INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY-IKC



IKC, Initiative for Kosova Community është themeluar në vitin 2005 si një prej organizatave lokale joqeveritare në Kosovë. Ajo është formuar si spin-off organizatë e organizatës joqeveritare belgjiane Balkanactie vzw. Ajo është themeluar nga personeli lokal i Balkanctie vzw. Duke ditur se Kosova vuan nga shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë, përjashtim të grave nga aktivitetet socioekonomike, ne i drejtuam resurset tona kah zhvillimit socioekonomik të Kosovës. Momentalisht IKC-ja po zbaton dy projekte, një të financuar nga Kooperativa Suedeze We EFFECT, kurse tjetri i financuar nga Ambasada Britanike. Të dy projektet kanë për qëllim zhvillimin e shoqërisë rurale të Kosovës nëpërmjet

organizimit dhe zhvillimit të biznesit. Për faktin se IKC-ja i përfshin të gjitha grupet etnike, gjinitë dhe sidomos bashkësitë e marginalizuara, IKC-ja punon në 10 komuna ku për nevojat për punësim janë më tepër se kryesore: Ferizaj, Shtime, Lipjan, Viti, Klllokot, Stërpçe, Partesh, Han i Elezit, Kaçanik dhe Gjakova. Deri më tani IKC-ja ka organizuar mbi 700 bujq në organizata të grave (WOs) dhe në organizata bujqësore (FOS). Midis tyre, më tepër se 50% janë WO, kështu që gratë përforcohen ekonomikisht, politikisht dhe në anën sociale.

FONDACIONI AGRINET ALBANIA



AgriNET është organizatë shqiptare apolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse e regjistruar në shkurt të vitit 2005 me seli në rajonin e Korçës. Tani ajo është rrjetë e 15 organizatave bujqësore nga tre rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj organizate është pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në proceset sociale, ekonomike dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive të cilat jetojnë në rajone rurale në partneritet me sektorët ruralë të marginalizuar, bashkësitë e tyre dhe palët e ndryshme të prekura. AgriNet e realizon misionin e vet nëpërmjet implementimeve të ndryshme në projektin në fushën e zhvillimit rural financuar nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare, si edhe nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësive, pushtetit lokal dhe organizatave të tjera joqeveritare në fushën e zhvillimit rural të bashkësisë. AgriNet siguron shërbime të

zgjeruara në pjesën më të madhe të rasteve për grupe formale dhe joformale të prodhuesve bujqësorë. Lloji kryesor i grupeve bujqësore për shërbime të zgjeruara janë: grupet e prodhuesve të cilët zbatojnë Praktika bujqësore të mira (Good Agricultural Practices - GAP), zbatim i trajnimeve të moderuara nga ekspertë në nivel nacional, organizim i shkëmbimit të përvojave për prodhuesit bujqësorë inovativë, organizim i parcelave demonstruese për testim dhe zbatim të teknologjive inovuese dhe zhvillim të publikimeve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e teknologjive inovuese dhe GAP.